

INTERVISTA
EDVIN LIBOHOVA,
BANKIERI I SUPERLIGËS
► FAQE 4

INFRASTRUKTURA
ËNDRRA DHE REALITETI
BËHEN BASHKË
► FAQE 14

OBJEKTIVAT
REVOLUCIONI
I MUSTEDANAGIC
► FAQE 18



EURO DUKA



KOHA PËR TË NDËRTUAR TREGUN E FUTBOLLIT

Andi Vercani
Editor i revistës

Të flasësh për treg në Shqipëri është një temë që sigurisht mund të ngjallë reagime, dyshime, e deri te keqkuptime të mëdha. Mund të tingëllojë dhe si utopike, duke parë që në këtë vend tregu nuk është ndërtuar në shëndetësi, arsim, e në shumë shërbime publike. Por futbolli në Shqipëri ka treguar që është gjithmonë një hap përpara. Sigurisht që procesi i

ndërtimit të këtij tregu do të ketë vështirësi, dhimbje, por është një domosdoshmëri. Gati një dekadë më parë, Federata Shqiptare e Futbollit pas sugjerimeve të UEFA-s i kërkoi klubeve transformimin e formës juridike për tu kthyer në shoqata, shpk apo shoqëri aksionere, si një hap i parë drejt strukturimit tregtar të këtyre klubeve dhe ndërtimit të tregut të futbollit. Procesi sigurisht që ishte i vështirë dhe nuk mund të arrihej në perfeksion gjithçka brenda një periudhe të shkurtër kohore, kjo dhe për faktin sepse ky ndryshim statusi ligjor i klubeve të futbollit kërkonte një seri ndryshimesh ligjore që do të lehtësonin fazën e parë kalimtare. Këto ndryshime për shumë vite nuk ndodhën, me bashkitë që realizuan vetëm ndryshimin e statusit ligjor të klubeve, duke stopuar aty. Shumë herë këto ndryshime që janë propozuar nga Federata Shqiptare e Futbollit janë bllokuar, ose në variantin më të mirë, nuk kanë gjetur mbështetjen e duhur. Kjo asesi nuk ka penguar institucionin e futbollit në Shqipëri që në vazhdimësi të ngrejë këtë çështje për diskutim duke ju drejtuar të gjithë aktorëve. Koha për të bërë kalimin nga gjëndja amorfe ku ndodhemi, ku në njërin anë shumë klube administrohen nga bashkitë sipas inercisë etatiste apo disa të tjera ku aksionet janë të ndara pothuajse barazi ndërmjet bashkive dhe privatit, drejt reformimit dhe krijimit të kushteve për mirëfunksionimin e tregut të futbollit ka ardhur. Insistimi i qeverisë së futbollit shqiptar për të përmirësuar futbollin shqiptar, nuk do të jetë kurrë i mjaftueshëm nëse nuk shkohet drejt zgjidhjes përfundimtare që është privatizimi dhe funksionimi i klubeve shqiptare sipas parimeve të tregut dhe ligjeve tregtare. Kjo sigurisht që kërkon vullnet nga të gjithë palët, për një të mirë të përbashkët që do të shërbente futbollit shqiptar për të bërë kalimin e madh përpara. FSHF ishte e para që bëri lëvizjen e madhe, duke propozuar ndryshime rrënjësore në disa ligje për të krijuar tregun e futbollit dhe nxitur tërheqjen e investitorëve në sport. Në anën tjetër, qeveria shprehu gatishmërinë për të dhënë kontributin e saj duke ndryshuar disa ligje dhe ofruar lehtësira fiskale për ata që investojnë në sport, duke ndihmuar në formalizimin e sistemit dhe shëndoshjen financiare të klubeve. Jemi në rrugën e duhur, hapat e parë pozitiv janë hedhur....

Përmbajtje



NR.30, PRILL 2019

Botim zyrtar i Federatës
Shqiptare të Futbollit

BANKIERI I SUPERLIGËS

► **FAQE - 4**

EURO DUKA

► **FAQE - 8**

NE JEMI NJË, FSHF DHE VODAFONE RIKTHEJNË BASHKËPUNIMIN

► **FAQE - 12**

INFRASTRUKTURA, ËNDRRA DHE REALITETI BËHEN BASHKË

► **FAQE - 14**

REVOLUCIONI I MUSTEDANAGIC

► **FAQE - 18**

NEWS

► **FAQE - 23**

PËRGJEGJËSIA SOCIALE

► **FAQE - 26**

SEZON I RI, EMOCIONË TË REJA

► **FAQE - 28**

100 VJET VLLAZNIA, "DJEPI" I FUTBOLLI SHQIPTAR

► **FAQE - 32**

EUROPA JURIDIKE ZBARKON NË TIRANË, WORKSHOP NDËRKOMBËTAR MBI TË DREJTËN SPORTIVE

► **FAQE - 34**

PANAJOT PANO TANI I NDËRKOMBËTARIZUAR

► **FAQE - 38**



Armand Duka

PRESIDENT I FEDERATËS
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT

TË NDERUAR LEXUES! TË DASHUR MIQ!

Rikthehemi në faqet e “Albania Futboll Magazinë”, për të rivedosur komunikimin e munguar me ju dhe për të përcjellë mesazhet tona, në lidhje me arritjet dhe projektet që kemi patur për zhvillimin e futbollit shqiptar. Gjatë kësaj periudhe, kanë ndodhur shumë ngjarje të cilat kanë lenë shenjë dhe na kanë motivuar në punën tonë. Të përqëndruar për arritjen e objektivave që i kemi vënë vetes, që në shpalosjen e tyre, në asamblenë e kaluar në mars të vitit 2018, ne kemi sot mundësinë që të bëjmë një bilanc të shkurtër të punës dhe arritjeve që kemi patur në harkun kohor të një viti. Kollonat tona kryesore të zhvillimit të futbollit, të konceptuara si prioritet, janë të përcaktuara edhe në strategjinë afatshkurtër (2018-2022) dhe tek vizioni ynë për të ardhmen (2018-2030). Ato tashmë, kanë nisur që të zbardhen në shifra dhe në rezultate konkrete.

Zhvillimi i futbollit të fëmijëve dhe ai i moshave, është një prioritet kryesor i punës tonë. Nëpërmjet “Projektit Grow”, ne synojmë masivizimin e futbollit dhe shtrirjen e tij në kategoritë e moshave 7-9 vjeç. Kemi patur objektiv, përfshirjen dhe regjistrimin në futboll i 24.000 fëmijëve të kësaj kategorie në vetëm 4 vjet. Vetëm në vitin e parë kemi regjistruar mbi 14 000 fëmijë. E llogaritur ndryshe objektivi ishte 6000 në vit që do të thote 6000 fëmijë në vit janë pjesë e projektit ku në shkollat fillore luhet 1 herë në javë futboll në orën fiskulturës.

Po kështu një prioritet të rëndësishëm, ne kemi futbollin e femrave, tek zhvillimi i të cilit, në të gjithë Shqipërinë kemi përqëndruar të gjitha energjitë tona. Si objektiv kemi patur krijimin e kombëtares U-17, brenda këtij katërvjeçari. Ndërkohë që ai është arritur që në vitin e parë, kur mundëm që ta

krijonim këtë skuadër kombëtare, e cila mori pjesë edhe në eliminatoret e Kampionatit European. Me këtë ritëm ne synojmë që të shtojmë numrin e skuadrave dhe të zgjerojmë shtrirje gjeografike të tyre, në mënyrë që femrat të luajnë futboll në çdo kënd të Shqipërisë.

Ndërkohë që përmirësimi i infrastrukturës, ka qenë dhe mbetet një pikë e rëndësishme referimi për ne gjatë gjithë kësaj periudhe. Përfundimi i punimeve në stadiumin kombëtar, që do të realizohet së shpejti, do të shoqërohet edhe mbarimin e punimeve në “Shtëpinë e Futbollit. Këto janë dy vepra madhore, të cilat do ta rrisin reputacionin e futbollit shqiptar dhe do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e imazhit dhe organizimit të aktiviteteve të rëndësishme, kombëtare dhe veçanërisht ndërkombëtare. Ndërkohë që po punohet edhe për ndërtimin e dy ministadiumeve me kapacitet 500 vendësh pikërisht pranë rezidencës së FSHF.

Të dashur miq!

Krahas objektivave të rëndësishëm që i kemi vënë vetes, ne për asnjë çast nuk kemi harruar, atë që është thelbësore: Krijimin e një terreni sa më të përshtatshëm për zhvillimin e futbollit shqiptar në të ardhmen. Për këtë arsye, ne kemi nisur prej kohësh një diskutim të hapur me të gjitha hallkat dhe strukturat e shtetit shqiptar për hartimin e një legjislacioni që krijon lehtësi dhe hapësira për zhvillimin e futbollit. Ky, do të jetë një shërbim i rëndësishëm dhe me vlerë afatgjatë, për të ardhmen e sportit më të rëndësishëm në vend.

Duke ju uruar suksese në punën tuaj, shpresoj që ç’ ka paraqita më lart, të jetë një pikë referimi në objektivat tona të përbashkëta.

BANKIERI I SUPERLIGËS

Edvin Libohova, presidenti i Ligës, në një rrëfim unik në lidhje me të ardhmen e bashkimit të klubeve superiore

Njësoj si në romanin e famshëm të Lesli Uoller, me të njëjtin emër, Bankieri. Duhet një shpikje. Potenciali është i madh, por pothuaj të gjithë faktorët ose janë kundër, ose janë deri diku premtues. Njësoj si dija e përgjysmuar. Ndonjëherë është më mirë të mos dish. "Mund t'ia dal", mendoi Edvin Libohova, teksa rrufit një kafë të shkurtër, në zyrat e tij, në ish-blok. Futboli dhe Kategoria Superiore mund të shndërrohen në një biznes.

Kush ishte arsyeja e angazhimit tuaj në futboll?

Kam qenë dhe më herët pjesë e futbollit. Nga viti 1994-1998 u organizua një komitet drejtues në nivel meanxherësh dhe aderova në atë përfaqësi. Jam tifoz i amdh i futbollit dhe kjo fushë më ka joshur shpesh. Për vite me radhë ka qenë e pamundur t'i përgjigjesha ftesës së institucionit pas angazhimeve që kam pasur në bankë. Tani jam më i lirë, jam konsulent dhe mund të impenjohem seriozisht.

Ju jeni zëvendëspresidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit dhe më së shumti jeni angazhuar në krijimin e Ligës. A e dini se 8 vite më parë ka pasur një përçapje që ka dështuar në këtë drejtim?

Po, jam në dijeni të komisionit të klubeve, i cili duhet të ishte një fazë transitive për të shkuar te Liga. Nuk mund të gjykoj përse nuk pati sukses atëherë, por ndoshta si klubet, ashtu dhe ligjet përkatëse, por pse jo dhe institucioni, nuk ishin gati për të ndërmarrë një hap të tillë.

Liga nuk ekziston në disa vende të rajonit. Përse mendoni që do funksionojë në Shqipëri?

Po, jam në diejini që në disa vende të rajonit nuk ekziston, por kjo nuk do të thotë që ne s'duhet të jemi pararojë në këtë drejtim. E them me bindje që kemi futboll më të zhvilluar se rajoni, sidomos në nivel ndërkombëtar. Modeli që ne po synojmë është liga hungareze. Ajo ka një përjasje të shkëlqyer mes anëtareve të Superiores dhe shtetit apo faktorëve të jashtëm.

Sa skuadra do ketë Liga e futbollit?

10 ekipe ato që marrin pjesë në superiore. Në rast se skuadra bie nga kategoria humbet të drejtat dhe zëvendësohet me klubin që ka fituar të drejtën e pjesëmarrjes.

A mendoni se duhet të ndryshojë numri i skuadrave në superiore?

Kjo është një pyetje që duhet shtruar në tryezën e ligës. Nuk besoj se numri është shumë i rëndësishëm. Shumica e vendeve me kapacitetet tona kanë 10 apo 12 skuadra në superiore. Më shumë se sa numri, duhet të rrisim nivelin e organizimit të klubeve që hyjnë në Superiore ose janë prezente.

Çfarë do të thotë kjo?

Po mendohet të hartohet një kriter i ri licencimi dhe dalëngadalë të rrisim nivelin e infrastrukturës dhe sidomos të kushteve, në mënyrë që ata që luajnë në Superiore të mos kenë diferenca.

Ju besoj e dini se në çfarë niveli është Kategoria e Parë, nga vijnë edhe ekipet për në superiore?

Liga do insistojë që në kohë të shkurtër Kategoria e Parë të ketë 12 ose 14 skuadra, në mënyrë që atje gara të jetë e fortë dhe niveli i klubeve t'i afrohet Superiores në shumë drejtime. Diferencat duhen zbutur.

Diskutojmë pak disa çështje të nxehta në futbollin shqiptar. Matchfixing si temë?

Me përgjegjësi të plotë them që numri i ndeshjeve të dyshuara të trukuara sipas raporteve që vijnë nga UEFA kanë rënë në mënyrë drastike në vitet e fundit. Këtë fenomen e mbulon monitorimi i shumave të vëna të basteve nga UEFA, federata me komisionin e Etikës dhe prokuroria. Liga më së shumti do jetë bashkim menaxherial dhe pse jo financiar.

Sa do jenë kostot e ligës dhe kush do t'i garantojë ato?

Fillimisht kemi një buxhet afro 10 milionë lekë të reja, që do na duhen për afro një vit për shpenzimet administrative.

Do operoni brenda FSHF-së, apo më vete?

Më vete do kemi stafin tonë dhe do krijojmë një strukturë të veçantë për Superioren.

A do e mbulonin ju zhvillimin e aktivitetit?





Po, qëllimi është ky. Kalendaret, oraret, të gjithë detajet që i përkasin Superiores. Madje duam që dalëngadalë të kemi dhe delegatët e ndeshjeve, duke qenë se kanë lidhje direkte me organizimin e ndeshjes.

Gjyqtarët janë gjithnjë një pikë e nxehtë?

Dizenjatorët dhe komisionet e vlerësimit dhe ndëshkimit do jenë ende në varësi të Federatës, por ne do kemi përfaqësuesit tanë, të cilët do dublojnë vendimet dhe monitorimin e situatës. Lista e gjyqtarëve dhe vlerat e tyre do diskutohen mes partnerëve dhe klubeve.

A është Liga një sfidë për FSHF-në?

Nëse gjithçka po bëjmë do përkthehet kështu, besoj se jemi të tërë gabim në perceptim. Jo vetëm që nuk është sfidë, por jemi partnerë të shkëlqyer. Fillimisht, derisa të konsolidohet, Liga e ka të pamundur organizimin financiar dhe logjistik pa ndihmën e Federatës.

Klubet shpesh janë ankuar në lidhje me shpërblimet që marrin në varësi të trofeve?

Më është dukur gjithnjë një vërejtje me vend, por të gjithë termat financiare, që duhen riparë, duhen justifikuar me të ardhura. Sigurisht që ndonjë subvencion nga Federata mund të ketë, por herët a vonë kapitali duhet krijuar nga vetë në, nga klubet.

Nëse do ishte në dorën tuaj, si do funksionte sistemi i shpërblimeve?

Ne shpërblejmë fituesen e kampionatit dhe kupës, por në mënyrë urgjente duhet të fusim shpërblimet për çdo pozicion në renditjen përfundimtare të kampionatit, në mënyrë që çdo ndeshje të vlerësohet nga klubet, edhe kur kanë dalë nga objektivat madhorë.

Si mund të sigurohen paratë?

Ka forma të ndryshme. Një nga format mund të jetë rishëprndarja e të ardhruave dytësore të paparashikuara. Gjrobat, për shembull, janë një mundësi e mirë.

Në FSHF për momentin është komisioni i Ligës, i cili nën drejtimin tuaj duket ka filluar t'i diskutojë të gjithë këto idetë?

Po, është një komision që përfaqësohet nga dy anëtarë, të cilët janë përfaqësues të klubit të Tiranës dhe Partizanit. U bëmë propozime klubeve për pjesëmarrës dhe unë jam i kënaqur nga kontributi i të dyve dhe në përgjithësi nga ky komision. Sektori i garave është gjithashtu present, me asistencë dhe ide në çdo moment.

Flitet për bashkim të ardhurash, por kjo duhet shndërruar në një markë. Në çfarë niveli promocion al gjendet imazhi i kampionatit në këto moment?

Nuk mund të them që kemi kuota të mira. Përveç së drejtës televizive dhe kontributit të Digitalb, nuk kemi pasur mundësi për të krijuar një sponsor gjeneral për kampionatin. Edhe në klubet në vuajmë ndjeshëm në këtë sektor.

Kush janë arsyet?

Paketa ligjore "Futbolli për 100 ditë" besoj që ka qenë e nevojshme të zhvillohej më parë. Kjo paketë kam garanci të plotë që do afrojë shumë kompani serioze, jo vetëm si sponsorë, por edhe si aksionerë. Ligji do ketë lehtësira të jashtëzakonshme, madje edhe përfitime në këtë drejtim. Një nga parimet bazë të biznesit të futbollit – biznes shumë i vështirë për t'u shndërruar në rentabel – është hapja sa më shumë e gamës së donatorëve. Një apo dy njerëz të vetëm do kenë gjithnjë vështirësi për të administruar klubet. Sot kemi 8 klube që janë shoqëri aksionere dhe dy klube shoqata. Nga ana tjetër, besoj



macron



FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT
UNIFORMAT E REJA TË LOJËS - SEZONI 2019-2020



duhet ndërtuar një strategji komunikimi me publikun dhe roli i medias në këtë moment është përcaktues.

Çfarë do të thotë kjo?

Mund të jetë dhe në natyrën e medias në ëprgithësi, por rastet shpesh të izoluar të dhunës apo fenomenet negative trumbetohen dhe kjo sjell largimin e interesit të njerëzve. Ne jemi një ligë dhe si do ligë e tillë në Europë, vuajmë disa faktorë, konkurrenca e ligave të mëdha, televizioni dhe fluksi i madh i informacionit. Për të ndërtuar një markë të mirë duhet të kemi një imazh të mirë.

A mund të bëhet më shumë për të pasur më shumë tifozë në stadium?

Tifozi është qëllimi kryesor ekonomik i gjithë kësaj sipërmarrjeje. Në fund do paguajë ai dhe nëse krijojmë një numër më të lartë tifozësh do kemi një futboll më të mirë. Shifrat zyrtare që kemi janë konkurruese me rajonin, por mund të bëjmë më shumë.

Kush janë format?

Do rishikojmë kodin e drejtësisë sportive. Dënimet kolektive dhe stadiumet e mbyllura janë në përpjesëtim të zhdrejtë me dëshirën tonë për të promovuar futbollin. Ka klube në Shqipëri që e kanë nisur dhe e kanë ndërprerë sistemin e abonimeve, sepse nuk kanë mundësi t'u ëprgigjen njerëzve, duke qënë se shpesh dyert janë të mbyllura. Edhe kjo lidhet me ligjin që po hartohet. Stadiumet me kamera dhe ligji për evidentimin e atyre që krijojnë dhunë evitojnë dënimet kolektive.

Në raportet e fundit të UEFA-s thuhej që shumica e të ardhurave në futbollin shqiptar vijnë nga paratë e pjesëmarrjes në Europë, shumë pak, vetëm 17 përqind, nga shitja e lojtarëve dhe as 6 përqind nga sponsorizimi?

Duke vënë në qendër të motos sonë një lloj Fair Play të brendshëm financiar, jam i sigurt se klubet, duke krijuar një klimë më shumë financiare se sa sportive, do synojnë gjithnjë e më shumë prodhim dhe shitje lojtarësh. Nga të ardhurat nga UEFA përfitojnë vetëm 2-3 klube që marrin pjesë. Të tjerat duhet të gjejnë forma të tjera financimi ose të ardhurash.

Në ajër ndihet një informalitet në pagesa, çka krijon shumë problem?

Po, nuk e mohojmë që shumica e klubeve nuk bën deklarime reale. Edhe kjo lidhet me ligjin e ri. Nëse do kemi ulje drastike taksash, mos tatim mbi të ardhurat apo rimbursim TVSH-je, edhe klubet do jenë më komode në deklarimet e tyre.

Megjithatë, zëri i trajnerëve dhe lojtarëve duket se mungon. Të ngjan sikur janë më të pambrojturit?

Poltikat në lidhje me futbollin në përgjithësi dhe aspektin e tij social i ka për detyrë Komiteti Ekzekutiv i Federatës dhe besoj që ata duhet të jenë shumë të ndjeshëm në gjetjen e mënyrë që trajnerët dhe lojtarët të jenë deri diku të mbrojtur në kontratat e tyre.

Si mund të ndodhë kjo?

Përvoja e Dhomës së Zgjidhjes së Konflikeve ka qënë në përgjithësi e suksesshme. Kontratat më pas janë individuale dhe marrëveshjet po ashtu.

Ka raste si Kamza që është përjashtuar dhe lojtarët jo vetëm që nuk paguhen, por rrezikojnë edhe të humbasin vlerën e kontratës pasi klubi shkoi në Kategoritë të Dytë?

Nga precedentët duhet të mësojmë. Propozimi im është që lojtarët t'i sugorjnë kontratat e tyre në kompanitë e specializuara në rast përjashtimesh apo falimentesh dhe kështu mund të evitojnë probleme të kësaj natyre.

Ku do fillojë zyrtarisht Liga nga puna?

Besoj në qershor do jemi në selinë tonë.

A shpresoni se në fund mund të arrihet dicka?

Fundi është koncept abstrakt. Nëse vjen fundi ke mbaruar. Nuk dua të shkojmë në fund. Dua çdo moment të përmirësohem. Asgjë nuk bëhet brenda ditës, por nëse kemi frymën e duhur dhe kuptojmë parimet bazë të këtij tregu prej 10 klubesh, patjetër që si ata që do hedhin paratë, si ata që do luajnë, por edhe tifozët, do jenë më të kënaqur dhe do e shijojnë më shumë.



EURODUKA

Shkurt 2019. Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, u zgjua në orarin e zakonshëm, por pavarësisht se e ka të vështirë ta pranojë, kishte bërë vetëm disa orë gjumë. Ai është si gjithë të tjerët, përpara ngjarjeve të mëdha, kujtimet janë ëndrrat që shoh me sy hapur gjatë natës. 17 vite më parë ishte zgjuar me të njëjtën ndjesi, teksa do votohej për president të institucionit që drejton sot. Nuk ishte

e thjeshtë. Në atë periudhë të futbollit, njerëzit ishin mësuar me idenë se futboli duhej drejtuar nga futboli. Në shumicën e rasteve ish-lojtarë me “dy pare mend” vendoseshin nëpër skrivani që me kalimin e viteve ishin pushtuar nga pluhuri dhe zyrat ishin zhvendosur nëpër pijetore të vogla, tërë afsh alkooli, disa metra më tutje. Si mundet një biznesmen i suksesshëm, tifoz vërtet, por pa ndonjë lidhje konkrete me fushën, të na

PRESIDENTI I FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT VOTOHET NË QEVERINË EUROPIANE TË TOP-KËMBËS. PELEGRINAZHI I PABESUESHËM I NJERIUT I CILI KUR ZBARKOI 17 VITE MË PARË NË FSHF THA: REVOLUCIONI NUK VJEN NGA FUSHA, POR NGA ZYRA!



drejtojë? Kjo ishte me sa duket arsyeja që fillimisht anëtarët ishin skeptikë. Shumica e tyre mendonin se paratë tani nuk do ishin një problem, ndërkohë që Duka, një ekonomist në profesion dhe administrator i disa firmave private, lëshoi një deklaratë që ndokujt nuk i pëlqeu: Nuk jam këtu për t'ju dhuruar para, jam këtu për të menaxhuar paratë tuaja. Kush është ky që do na mësojë ne ç'të bëjmë? Pastaj, ku ka lekë këtu?

Ne duam ca fanella dhe ca topa.

Në shkurtin e kaluar, në një prej hoteleve më të rëndësishëm të Romës, Duka e mendoi gjithë atë skenë kur u ul në poltronën e të nominuarit në kongresin e UEFA-s. Për herë të dytë kishte hedhur kandidaturën për të qenë pjesë e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s - e thënë në gjuhë popullore, qeveria e futbollit europian - dhe këtë radhë emocionet i kishte më të mëdha se sa herën ku humbi për pak vota. Në jetë është e rëndësishme të këmbëngulësh dhe Duka rikandidoi me besimin se tani kishte ardhur moment i duhur për t'ia dalë. Përvoja e tij në UEFA, si në komitetin e ekipeve kombëtare - Liga e Kombeve ishte gjithashtu një ide e tij - dhe sidomos në komisionet financiare ku për shumë kohë ishte përgjegjës për investimet, ishin arsye se përse presidentët e federatave të tjera duhej ta votonin. E gjitha kjo mund të mos mjaftonte. Kredibiliteti duhej shoqëruar me marrëdhënie personale, marrëdhënie që ai diti jo vetëm t'i ndërtonte, por dhe t'i mbante në nivele të kënaqshme ndër vite. Prezenca e tij në UEFA nuk kishte kaluar në heshtje, sikundër i ndodh një deputeti që pasi fiton mandatin struket në cepin e sallës së parlamentit dhe nuk mban as shënime. Në vitet e fundit, të paktën në dy moment betejat e tij kishin një kundërshtar të fortë, fillimisht UEFA-n vetë dhe më pas një sërë vendesh që me arsye objektive ose jo ishin kundër Kosovës, një skuadër zyrtare futbollit pa qenë ende pjesë e OKB-së. Të dyja i fitoi. Në rastin e parë FSHF fitoi gjyqin në CAS për ndeshjen kundër Serbisë në Beograd, një gjyq i fituar dhe i shoqëruar me rrudhje buzësh nga shumë federata, ndërsa në rastin e dytë, një fitore e madhe e gjithë shqiptarëve, në jo vetëm një lobing spektakolar. Fjalimi i Dukës ditën që Kosova u votua dhe u pranua me të drejta të plota në futboll ka qenë emocionues dhe i bëri shumë presidentë të ngrinin kartonin jeshil: Po, Kosova duhet të luajë njësoj si ne!

Atë ditë - pra në shkurtin e shkuar - Duka fitoi 36 vota, më se të mjaftueshme që të fitonte postin e anëtarit të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s. Ai nuk është njeriu i shpërthimeve, statura që ka, bizneset



dhe angazhimet në futboll e kanë bërë gjithnjë e më racional, por atë mbrëmje me siguri i ka dhënë vetes kënaqësinë e lumturisë. Njeriu në jetë jeton për ëndrrat që ka. Ai, pak a shumë, ia ka dalë.

Betejat kanë qenë gjithnjë motiv i jetës së tij. Thonë që janë pikërisht sfidat që të përmirësojnë, përballjet, duelet. Është mundur më së shumti t'i bëjë me fisnikëri dhe daljet publike kanë qenë gjithnjë të kujdesshme. Kujtoni fushatën e fundit për të fituar postin e presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit. Ajo nuk u ndërtua mbi akuza, debate apo një klimë armiqësore ndaj rivalitetit. Më së shumti u punua në terren, një për një me gjithë anëtarët, duke premtuar e duke konfirmuar besimin se futbollit në tërësi me të në krye vijon të administrohet në nivele të kënaqshme.

Shpejt e shpejt disa nga arsyet se përse jo vetëm është votëbesuar brena vendit në disa mandate, por edhe se përse e gjitha kjo do ketë pasur një ndikim qoftë dhe indirekt në mënyrën se si presidentët e federatës europiane kanë menduar kur kanë firmosur emrin e tij në letrën e votimit. Futbollit në drejtimin e tij ka pasur rritje të jashtëzakonshme në masivizim, në cilësi, dhe sidomos në të ardhura. Kombëtarja shqiptare është sot një skuadër e vërtetë europiane, si në aspektin e rezultateve, ashtu dhe në organizim. Me të në krye të federatës, Shqipëria u kualifikua për në Francë 2016, një ngjarje historike që në të shkuarën kish vështirësi për ta parë në ëndrrën më të bukur edhe tifozit më optimist i kësaj skuadre. Investimet kanë qenë një ndër pikat e tij më të forta. Fusha dhe stadione të bëra, impiante të licencuara nga UEFA, bazë materiale dhe bashkëpunim për zhvillim me çdo klub. Sot Shqipëria ka situatën më të mirë në rajon për sa i përket infrastrukturës. E parë në këtë këndvështrim, stadiumi i ri kombëtar që po ndërtohet në qendër të Tiranës ka qenë gjithnjë një objektiv i tij madhor, objektiv i cili pritet të



përfundojë në muajt në vijim.

Menaxhimi i Kategorisë Superiore, garës në vend dhe krijimit të një produkti gjithsesi me një farë vlere ekonomike, ka qenë një sfidë shumë e vështirë, por jo e pamundur. Sot kampionati shqiptar ka një të drejtë televizive më të lartë se rajoni, ndërkohë që subvencionet e Federatës për klubet në forma të ndryshme janë për t'u marrë shembull. Federata e ka konsideruar gjithnjë veten si shtëpia e futbollit dhe i ka trajtuar të gjithë anëtarët si fëmijët që duhet të kenë të gjithë një mundësi për t'u rritur. Nuk i ka dhuruar askujt asgjë, por është mundur t'i trajtojë dhe të krijojë një klimë të tillë që në fund rritja administrative të ndikojë direkt te rregullat e lojës. Gjatë gjithë këtyre viteve ai nuk ka reshtur së punuari që të rriten standardet. Në një vend si Shqipëria, ku hapat para janë të vështirë për t'u hedhur, ai nuk ka ndaluar jo vetëm së shpresuari, por edhe së punuari që institucioni që ai drejton të ketë shembuj ndërkombëtarë, dhe jo histori suksesi me karakter lokal.

"Si t'ua shpjegoj të gjithëve se kjo lojë, duam apo nuk duam ne, sot është një biznes dhe nëse nuk e shohim kështu, nuk kemi asnjë mundësi që të jemi konkurrues?". Futbollit para Dukës ishte si një femër që mendonte se ishte e bukur, por që për të jetuar mjaftonte të ishte përkrah një bashkëshorti



të pasur. Duka kishte tjetër koncept. E para, bukuria është relative, e dyta, sado e vështirë të jetë, duhet “të mbajmë veten”, pa shtrirë dorën te askush. Klima sot në futbollin shqiptar i ngjan një vetëfinancimi deri diku të kënaqshëm. Shteti prej shumë vitesh nuk i hodhi sytë nga futbollit, por duke qenë se pa shtetin është shumë e vështirë të operosh, Duka vendosi që të shkonte vetë në komisionin e ligjeve dy vite më parë dhe të thoshte: “A e kuptoni ju që jeni i vetmi shtet në Europë që jo vetëm nuk bëni subvencione, por nuk krijoni as ligjet e duhura?”. Si çdo nismë, fillimisht veshi ishte i urdhër. Njeriu këmbëngulës besoi deri në fund dhe vetëm disa ditë më parë negocioi që kryeministri i vendit të ulej përpara futbollit dhe të dëgjonte të gjithë ata që po japin shpirtin për këtë lojë. “Futbolli në 100 ditë” ishte projekti i fundit, një revolucion i vërtetë që parashikon lehtësira dhe favorizime marramendëse. Ulja e taksave, ndoshta zerimi e tatimit mbi fitimin dhe të ardhurat, rimbursim i TVSH-së, futja e stadioneve si asete në shoqëritë tregtare, bashkëfinancime me shtetin në infrastrukturë dhe një pjesë e TVSH-së së përgjithshme të biznesit kalon si fond për zhvillimin e futbollit. Lehtësira për të gjitha ata që duan të sponsorizojnë. Jo keq. Diçka është arritur. Pothuaj gjithçka, do thuhet kur të bëhet realitet.

Në përgjithësi jeta është një përmbledhje e dy filozofive. Aforizmave të njerëzve të mëdhenj, dhe pak a shumë si futbollit, një lloj skeme apo ideje se si duhet të luash. Në jetë gjithsesi do të të kritikojnë, do flasin keq për ty, dhe është e vështirë të gjes rreth e rrotull njerëz që sa më shumë përmirësohesh, aq më shumë do të të bëjnë komplimente. Kështu që duhet të bësh atë që mendon, bëj gjithçka si duhet. Nëse bën kështu, ndoshta një ditë salla do duartrokasë. Po dhe nëse nuk ndodh kështu, me siguri do e kenë në ndërgjegje. Ca më shumë në Shqipëri, në vendin ku fjalë ku fjalë e mirë është e aq e vështirë sa të ndërtohet nga e para... një stadium.

Sfidat e së ardhmes? Masivizimi, fëmijët, femrat, shndërrimi i futbollit në një sport elitare, klimë biznesi dhe pse jo, një ditë Shqipëria në Botëror! Kjo është ëndrra e tij e madhe. Kur 36 presidentë federatash votuan Shqipërinë, gjë që kushdo dyshon se mund të ndodhë në ndonjë aspekt tjetër të jetës, Duka kujtoi ditën e parë që zbarkoi në Federatë. Njerëzit atëherë thoshin, si ka mundësi që një njeri që nuk i ka rënë asnjëherë topin mund të drejtojë futbollin? Ju kujtua Sacchi, i cili mbahet mend edhe për shprehjen: Për t’u bërë një trajner i mirë nuk duhet të kesh qenë detyrimisht kampion; një kalorës nuk ka qenë kurrë... kalë!



NE JEMI NJË, FSHF DHE VODAFONE RIKTHEJNË BASHKËPUNIMIN

Vodafone Albania do të jetë për 6 vite sponsori zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit

Vodafone Albania do të jetë për 6 vite sponsori zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit. Kontrata e sponsorizimit për tre sezone radhazi u nënshkrua në konferencën për shtyp, u organizua gjatë grumbullimit të kombëtares në muajin mars, në prani të përfaqësuesve të lartë të Federatës Shqiptare të Futbollit dhe Vodafone Albania.

“Ne jemi Një” do të jetë slogani shoqërues i mbështetjes që Vodafone Albania rikthen edhe një herë, pas shumë vitesh për Kombëtaren Shqiptare, duke theksuar angazhimin e saj për të qenë, në të mirë e në të keq, pranë skuadrës së zemrës së



Presidenti i Federatës së Futbollit, Armando Duka,
Presidenti i Vodafone Albania, Achilleas Kanaris dhe
lojtari i Kombëtares Elseid Hysaj

klentëve të saj. Duke pasur si synim kryesor ndarjen e krenarisë dhe emocioneve të fitores me të gjithë popullin shqiptar, falë këtij bashkëpunimi me FSHF-në dhe mundësive që të krijon rrjeti i shpejtë Gigabit, Vodafone do të sjellë një sërë përfitimesh për klientët Vodafone, duke prezantuar për ta mundësi nga më të ndryshmet, për të mos humbur asnjë ndeshje të skuadrës së zemrës. Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Z. Armando Duka falenderoi Vodafone Albania për mbështetjen që po i jep ekipit Kombëtar: “FSHF dhe Vodafone Albania kanë një histori të gjatë bashkëpunimi. Ndoshta jo rastësisht kemi të përbashkët ngjyrën e kuqe por dhe vendosmërinë për të arritur rezultate sa më të larta. Prej Vodafone Albania, që është sot lider në tregun shqiptar, FSHF nuk do të përfitojë vetëm mbështetjen financiare por edhe mentalitetin e liderit, e fituesit. Jemi në prag të një edicioni shumë të rëndësishëm, të eliminatorës 2020. Uroj që të kemi fillimin e mbarë me ndeshjen ndaj Turqisë e që kjo marrëveshje të na sjellë fat”.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Drejtori i Përgjithshëm i Vodafone Albania, Z. Achilleas Kanaris, tha: “Jemi shumë krenarë që nisim këtë partneritet me ekipin

Kombëtar shqiptar. Në çdo vend ku ne operojmë, nuk duam të konsiderohemi vetëm si një kompani e madhe, por edhe si investitor të vazhdueshëm në gjithçka që ka rëndësi për komunitet. Për ne ishte shumë e thjeshtë t’i thonim po këtij sponsorizimi, duke parë se skuadra Kombëtare e Futbollit është pikërisht ajo që i bën shqiptarët krenarë, të bëhen bashkë, të qajnë, të lumturohen, të brohorasin. Pjesë e bukur e këtij bashkëpunimi është padiskutim përdorimi i teknologjisë, që u mundëson fansave të jenë gjithnjë të lidhur me skuadrën e tyre të zemrës, kur janë në fushë por edhe jashtë saj. Ju uroj suksese në ndeshjen me Turqinë dhe në vijim, drejt kualifikimit”.

I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes FSHF-Vodafone ishte edhe kapiteni Shqipërisë, Elseid Hysaj, i cili nuk e fshehu kënaqësinë për këtë arritje të rradhës të federatës. “Dua të uroj Presidentin Duka për këtë arritje të madhe që ka bërë, duke firmosur me një sponsor të madh si Vodafone, dhe shpresoj shumë që kjo të na sjellë fat në këto kualifikuese drejt Euro 2020. Do të bëjmë maksimumin dhe më të mirën për këtë kombëtare që të kualifikohemi për në Kampionatin Europian”.

Në një kohë kur teknologjitë e reja janë të dizajnuara për t’u ofruar klientëve përvoja më të bukura, Vodafone ofron rrjetin më të mirë për të mbështetur këto përvoja. Partneriteti me skuadrën kombëtare të futbollit është një tjetër shembull i përgjegjshmërisë së biznesit dhe angazhimit të saj për t’u gjendur pranë nevojave të klientëve, edhe përtej komunikimit.

Nga “Arena Kombëtare” e deri te “Shtëpia e Futbollit” që janë shumë pranë përrurimit: si po ndryshon infrastruktura në futbollin shqiptar dhe investime të rëndësishme pritet të realizohen në të gjitha impiantet e qyteteve kryesore të vendit



INFRASTRUKTURA, ËNDRRA

Infrastruktura në futbollin shqiptar, dikur në nivele dramatike, vitet e fundit ka njohur zhvillime shumë pozitive duke u investuar në shumë stadione dhe fusha stërvitore. Për të pasur një futboll në nivele të larta dhe konkurues nevojitet shumë më shumë vëmendje për infrastrukturën nga pushteti qendror dhe ai lokal, si për të ruajtur ato ambiente ekzistuese por edhe për të ndërtuar të reja duke shtuar inventarin e fushave të futbollit kudo nëpër Shqipëri. Përtej vështirësive, dhe mungesës së vëmendjes nga shteti, Federata Shqiptare e Futbollit vitet e fundit ka kryer investime të mëdha duke ndryshuar kushtet në dhjetëra impiante duke filluar nga Kategoria Superiore, te Kategoria e Parë dhe Kategoria e

Dytë. Në fillim të viteve 2000 skuadra kombëtare shqiptare dhe ekipet kombëtare të moshave nuk kishin një fushë stërvitore të denjë për tu stërvitur. Filloi gjithçka me Qendrën Stërvitore në Kamëz për të kaluar më pas në rinovimet e stadioneve dhe për të arritur te ndërtimi i dy stadioneve të kategorisë 4 sipas përkufizimit të UEFA-s, siç është “Elbasan Arena” dhe “Loro Boriçi” ku luan Shqipëria dhe skuadrat shqiptare që marrin pjesë në kompeticionet europiane. Dy investimet më të mëdha të FSHF, “Arena Kombëtare” dhe “Shtëpia e Futbollit” janë drejt përfundimit dhe këtë vit do të përurohen. Fokusimi te këto dy investime të mëdha nuk ka ndikuar që të harrohen impiantet e tjera në



DHE REALITETI BËHEN BASHKË

Shqipëri, si edhe hartimi i projekteve të reja për të pasur stadione dhe fusha stërvitore dinjitoze nga Kukësi në Delvinë.

“ARENA KOMBËTARE”

Në fillim të diskutimeve për ndërtimin e “Arenës Kombëtare” ky projekt shikohej nga shumë njerëz si objektiv utopik, diçka e pamundur për nivelet e futbollit shqiptar dhe buxheteve për sportin në Shqipëri. Sot që jemi shumë afër shijimit të ndeshjes së parë në stadiumin më modern në Shqipëri, dhe mbase më të mirin në rajon, emocionet janë shtuar dhe tifozët janë entusiast për të pritur një ndeshje në një “Arenë” që do të ketë një kapacitet prej 22.000

vëndesh dhe me të gjitha tribunat e spektatorëve të mbuluara. Që në fazën e projektimit, stadiumi i ri kombëtar është parashikuar të shfrytëzohet si një godinë publike gjatë të gjithë vitit, siç ndodh me të gjithë stadiumet e rinj që janë ndërtuar sot kudo nëpër botë, për ta kthyer në një pikë referimi për kryeqytetin. Godina do të përmbajë mbi 14.000 metra katrorë qendër biznesi, nga të cilat 4 mijë metra katrorë do të jenë sipërfaqe në dispozicion të Federatës Shqiptare të Futbollit. Arena Kombëtare ka një kosto përreth 60 milionë eurove dhe po ndërtohet përmes një skeme partneriteti publik-privat. Ky impiant, për nga kushtet që ofron, është i Kategorisë 5 sipas përcaktimit të UEFA-s, por

NËSE DËSHIRONI TË SIGUROHENI
ka vetëm 1 emër...



Mendo sa e thjeshtë është të sigurohesh Online!

Bli online siguracionin që të duhet nga celulari ose kompjuteri.




SHTEPI



SHENDET



MAKINE



Shkarko aplikacionin
SIGAL UNIQA



Download on the
App Store



GET IT ON
Google Play



Tel: +355 4 2233 308



www.sigal.com.al



info@sigal.com.al



SIGAL UNIQA



vetëm kapaciteti ndikon që të zbresë një shkallë më poshtë. Federata Shqiptare e Futbollit synon të zhvillojë ndeshje të rëndësishme ndërkombëtare në këtë stadium dhe për këtë është garuar për të marrë të drejtën e zhvillimit të Superkupës së Europës si dhe disa kompeticioneve të tjera.

“SHTËPIA E FUTBOLLIT”

Shtëpia e Futbollit është kompleksi munguar për futbollin shqiptar dhe ekipet kombëtare. Ashtu si edhe për “Arenën Kombëtare”, një kompleks i tillë për futbollin shqiptar shikohej si ëndër. Godina e re e FSHF, ku do të jetë e vendosur e gjithë administrata, dy mini-stadiume me bar natyral dhe artificial sëbashku me sistem ndriçimi, palestër, klinikë fizioterapie, salla konferencash, të gjitha këto të përmbledhura brenda një territori që do të jetë shtëpia e re e futbollit shqiptar. Ky kompleks do ti shërbejë të gjithë ekipeve kombëtare, duke filluar nga Kombëtarja U-15 dhe deri te ekipi A, të cilët do të kenë mundësi të zhvillojnë seancat stërvitore si edhe ndeshje miqësore përgjatë grumbullimeve të shumta që zhvillojnë në një vit.

STADIUMI LIBRAZHBIT

Një tjetër investim i rëndësishëm i Federatës Shqiptare të Futbollit në infrastrukturë për këtë vit është kryer në qytetin e Librazhdit, ku stadiumi qytetit është rinovuar plotësisht dhe fusha e futbollit ku zhvillon ndeshjet Sopoti është një investim i FSHF, me një vlerë rreth 60 mijë euro. Ky stadium dinjitoz do të jetë në dispozicion të ekipit vendas, ekipeve zinxhir, si edhe ekipeve kombëtare rajonale për moshat që do të kryejnë ndeshje miqësore. Në këtë mënyrë, sigurohet një stadium i rinovuar tërësisht dhe një hapësirë e re e zhvillimit social dhe ekonomik të qytetit të Librazhdit, një kontribut për të zhvilluar me tej dhe kultivimin e pasionit për futbollin tek brezat e rinj.

STADIUMI DELVINËS

Klubi Futbollit Delvina që milton në Kategorinë e Dytë është përfituesi i rradhës i investimeve që FSHF po kryen në të gjithë vendin. Në fillim të këtij muaji Presidenti Armand Duka i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Delvinës, Rigels Balili, përuruar fushën me bar artificial, një investim në vlerën e 150 mijë eurove mundësuar nga FSHF, për një nga qytetet më futbolldashëse në vend ku është luajtur futboll që në vitin 1918. Ky investim është në vazhden e mbështetjes që Federata Shqiptare e Futbollit i mundëson klubeve shqiptare për të siguruar infrastrukturën e duhur sportive.

STADIUMI I KUKËSIT DHE INVESTIMET E TJERA

Një stadium i ri modern brenda të gjithë parametrave për të zhvilluar ndeshje kombëtare dhe ndërkombëtare do ti shtohet Shqipërisë. FSHF është në procesin e finalizimit të projektit



të stadiumit të ri të Kukësit i cili do të jetë stadiumi i katërt i ri që federata i ‘ofron’ futbollit shqiptar. Punë e madhe është kryer edhe në impiante të tjera, pas kushteve të forta që sektori i licensimeve i ka vendosur klubeve për t’u licensuar për kompeticionet vendase dhe ato europiane, në këto kushte infrastruktura është një nga pikat më të forta, duke shtyrë klubet që të investojnë në impiantet përkatëse. Pak kohë më parë, falë financimit të FSHF stadiumi Niko Dovana dhe ai i Laçit kanë rinovuar tapetet, ndërkohë që investime të rëndësishme për përmirësimin e kushteve janë kryer dhe po vazhdojnë në shumë stadiume. Këto ndryshime të rëndësishme në infrastrukturë do të sjellin sigurisht rritje në cilësinë e lojës si edhe do të afrojnë më shumë tifozë në stadiume.



REVOLUCIONI I MUSTEDANAGIC:

Ja objektivat e ardhshëm të kombëtareve

Xhemal Mustedanagic, drejtuesi i Departamentit të Futbollit në Federatën Shqiptare të Futbollit ka nisur një projekt që synon të bëjë revolucion te ekipet kombëtare të moshave. Ky projekt shumë interesant që ka filluar të zbatohet nga muaji janar i këtij viti, është i

mbështetur në tre shtylla kryesore: Shtylla e parë është krijimi i kultit të kombëtares, ku çdo lojtar të ndjej nderin dhe përgjegjësinë e veshjes së fanellës kuqezi, si një fanellë që nuk mund të vishet nga të gjithë. Shtylla e dytë ka të bëjë me vendosjen e rregullave dhe



zhvillimi në çdo detaj i ekipeve kombëtare për të ardhur te shtylla e tretë që vetë Mustedanagic e quan fazën e përsosmërisë. Gjithçka në këtë projekt të drejtorit Mustedanagic bëhet për një qëllim madhor, siç është ndërtimi i një kombëtareje të madhe sa më cilësore dhe e furnizuar në mënyrë konstante nga ekipet kombëtare të moshave. Një objektiv shumë ambicioz por që në asnjë moment nuk duhet parë si i përealizueshëm, duke parë elementët e shumtë në Shqipëri si edhe talentet shqiptarë që luajnë jashtë vendit në skuadra dhe akademi shumë prestigjioze që mund të jenë brezi i artë i futbollit shqiptar. “Synimi ynë maksimal është që çdo vit të dërgojmë te kombëtarja e madhe 3 lojtarë, është shumë mirë sikur të shkojë edhe vetëm një, do të ishte një objektiv i realizuar. Unë jam shumë optimist, sepse Shqipëria ka shumë talente dhe potencial. Fëmijët shqiptarë janë shumë të lidhur me fanellën dhe e ndjejnë peshën e përgjegjësisë së përfaqësimit të këtij vendi. Duhet pak kohë dhe durim, por besoj se një ditë Shqipëria do të jetë në nivele të larta. Më pëlqen fakti që shumë shqiptarë që aktivizohen jashtë kanë shprehur gatishmërinë të vishen kuqezi. Këtë e

kemi parë edhe në grumbullimet e fundit që kemi zhvilluar nga U-15 deri te U-19. Natyrisht, nga jashtë do të marrim vetëm ata që janë “top player”, lojtarë që bëjnë diferencën në çdo aspekt, sepse nëse kanë të njëjtin nivel me ata që luajnë në kampionatin vendas, atëherë do të kenë prioritet futbollistët që aktivizohen në Shqipëri”. Ky revolucion e ‘detyroi’ Xhemal Mustedanagic të linte mënjane kostumin sportiv për të veshur atë të zyrtarit dhe tashmë në pozicionin e drejtorit të Departamentit të Futbollit ka marrë përsipër përgjegjësinë e ndryshimit të të ardhmes së kuqezinjve, duke zgjedhur që përtej ekipeve kombëtare A për çdo grupmoshë do të ketë edhe një skuadër B, me qëllimin për të testuar të gjithë lojtarët që shihen si potencial për ekipet kombëtare dhe për të mos gabuar në asnjë moment në procesin e seleksionimit. “Qëllimi kryesor është të shohim sa më shumë lojtarë që luajnë brenda Shqipërisë, të kenë mundësinë të aktivizohen dhe t’i vëzhgojmë nga pranë, mundësisht çdo javë me anë të përfaqësuesve tanë nga Sektori Ekipeve Kombëtare. Ekipi B të të gjitha grupmoshat do të ketë lojtarë që luajnë në Shqipëri, do të zhvillojnë ndeshje të forta për t’i testuar. Ekipin B do ta shfrytëzojmë edhe për lojtarë që dëshirojnë të provohen. Do të kemi mundësinë që provat të zhvillohen pikërisht tek ky ekip, duke mos e prekur skuadrën kryesore, aty ku kemi ndërtuar boshtin e skuadrës. Duhet që fillimisht lojtarët të kalojnë nga përfaqësueset B”. Projekti i ndërtuar nga ‘Xhemo’ ka në brendësi edhe një element tjetër të rëndësishëm: ekipet përfaqësuese rajonale që janë të ndërtuara në 6 zyrat rajonale të Federatës Shqiptare të Futbollit. Tirana, Durrësi, Fieri, Elbasani, Korça dhe Shkodra kanë tashmë skuadrat përfaqësuese nga mosha U-13 deri te U-17, ekipe që stërviten bashkarisht çdo ditë të hënë të çdo jave dhe këto stërvitje monitorohen në vazhdimësi nga i gjithë departamenti i futbollit, të cilët janë të shpërndarë nëpër qytete sipas një grafiku të përcaktuar qartë. Në këto stërvitje, sipas porosive të dhëna, kërkohet që të unifikohet puna me trajnerët e klubeve dhe stafeve rajonale që të punojnë në një linjë me lojtarët. Me ekipet përfaqësuese të rajoneve është ndërtuar edhe një kompeticion, Turneu i Ekipeve Përfaqësuese Rajonale, ku skuadrat zhvillojnë ndeshje ndërmjet tyre për të shpallur një skuadër fituese për çdo grupmoshë, por më shumë se fituesi vlerë ka monitorimi i vazhdueshëm i lojtarëve të çdo grupmoshe gjatë të gjithë vitit. Objektivi i vendosur nga Mustedanagic është i qartë: nuk duhet të humbasim kurrë një talent. Shqipëria U-17 dhe ajo U-19 kanë një objektiv, të arrijnë të kualifikohen për në “Elite Round” këtë vit, dhe Mustedanagic beson tek këto objektiva që nuk lidhen vetëm me kombëtaren e moshave, por edhe me kombëtaren e madhe. “Jam realisht optimist, e dimë që U-17 dhe U-19 kanë në grup skuadra të vështira dhe vërtet të forta, por gjithsesi kam besim se do të arrijnë të shkojnë në “Elite Round”. Kombëtarja e madhe mendoj se do të jetë pjesë e rëndësishme e futbollit europian, dua me gjithë zemër që Shqipëria të shkojë në Euro 2020”.

TRAJNERËT E PROJEKTIT MUSTEDANAGIC

Projekti i ri që ka nisur drejtori Mustedanagic sigurisht parashikonte dhe një rifreskim të stafeve të ekipeve kombëtare të moshave, për të sjellë energji të reja si edhe për të injektuar më shumë entusiasëm. Ndryshimet kanë filluar nga U-15 për të arritur deri te kombëtares e femrave. Egerem Memushi që drejtonte kombëtaren U-15 u zëvendësua nga Armand Dama, Elvin Beqiri u promovua në pozicionin e trajnerit të parë pas eksperiencës si ndihmës te U17, Erjon Bogdani që dha një kontribut të madh u zëvendësua me Nevil Deden tek U-19 ndërkohë që Alban Bushi mori rikonfirmimin në krye të 21 vjeçarëve. Në futbollin e femrave, drejtimi i 17 vjeçarëve ju besua Agustin Kolës. U-19, që më parë drejtohej nga Nevil Dede kaloi në drejtimin e Maringlen Kules ndërsa Vioresin Sinani mori drejtimin e kombëtares A duke zëvendësuar të mirënjohurin Armir Grima. Të gjithë këto ndryshime u bënë për një qëllim të vetëm, atë për ndërtimin e një kombëtareje të madhe sa më cilësore, e cila duhet të furnizohet çdo vit me element cilësor nga kombëtares e moshave.



ALBAN BUSHI U-21: OBJEKTIVI JONË ËSHTË FURNIZIMI I KOMBËTARES ME LOJTAR CILËSOR

Mua më vjen shumë mirë që do të vijoj të jem trajner i kombëtares U-21 dhe në këtë edicion të ri, më duhet të pranoj se ka qenë dhe është një emocion i veçantë përfaqësisimi i vendit tim. Dua të falenderoj drejtuesit teknik të Federatës, por në të njëjtën kohë edhe Presidentin për besimin e dhënë. Synimi im është të përmirësoj rezultatet dhe të shofim me optimizëm përpara, duke parë për të bërë më mirë në të ardhmen. Në çdo moment do kërkoj të kemi rezultate dhe të dërgojmë futbollistë nga U-21 tek kombëtarja A. Sikurse kemi vepruar edhe më herët, ku në edicionin e kaluar 3-4 lojtarë arritën kalimin e madh, do të vazhdojmë punën për të furnizuar kombëtaren A, por pa harruar në asnjë moment dhe rezultatet me skuadrën ku do të kërkojmë që në këtë edicion eliminator të lëmë së paku dy skuadra prapa.



NEVIL DEDE, U-19: PRIORITET LOJTARËT QË AKTIVIZOHEN NË SHQIPËRI

Për mua nuk është eksperiencia e parë tek ekipet kombëtare, pavarësisht se kam qenë tek femrat, për punën në ekipin e femrave U17 ndihem krenar, por sesa ia kemi dalë, pastaj këto janë histori që gjithë secili i vlerëson vetë. Unë në radhë të parë dua të jem i sinqertë dhe mbi të gjitha korrekt me veten, nëqoftëse respektoj veten time, atëherë respektoj institucionin që më jep besim, Presidentin dhe pjesën tjetër, të gjithë këtë staf të madh. Do mundohem që të kem informacion për çdo lojtar shqiptar për moshën që unë mbuloj, në të gjithë Shqipërinë, pastaj edhe jashtë saj duke i ndjekur nga afër dhe me skaut të gjithë shqiptarët kudo luajnë. Do mundohem të marr më të mirët nga të gjithë lojtarët, por nëse 1 lojtar shqiptar që luan këtu është i barabartë me atë që luan jashtë, do të merret ai që aktivizohet në Shqipëri, ky është prioritet.



ELVIN BEQIRI, U-17: DO BËJ MAKSIMUMIN PËR T'JU SHPËRBLIER BESIMIN

Në radhë të parë dua të falenderoj FSHF-në, Presidentin Duka për besimin që më kanë dhënë të drejtoj përfaqësuesen U-17. Për mua është eksperiencia e parë si trajner i parë, më herët para 1 viti isha trajner i dytë, ndihmës i profesor Xhemal Mustedanagic. Është një përgjegjësi e madhe por nuk duhet të mohoj se është edhe kënaqësi që rikthehem tek kombëtarja, ku më përpara kam kontribuar si lojtar dhe tani në pozicionin e trajnerit. Shpresoj ta shpërblej vlerësimin e bërë ndaj meje me seleksionimet cilësore që do të zhvillojmë gjatë të gjithë kohës dhe rezultatet që do të arrijmë. Faleminderit të gjithëve për përzgjedhjen time dhe shpresoj që do të bëjmë më të mirën gjatë kohës që do të drejtoj U-17, duke ju shpërblyer besimin e dhënë.

ARMAND DAMA, U-15: DO NDJEKIM ÇDO TALENT KUDO LUAN

Dua të falenderoj stafin e federatës dhe Presidentin për besimin që më dhanë të drejtoj U-15 e Shqipërisë. Jam koshient se do të jetë një sfidë e vështirë që të gjejmë më të mirët e kësaj moshe grup-moshe pasi është dhe seleksionimi i parë, filtri i parë për furnizimin e ekipeve kombëtare. Përgjegjësia sigurisht që është e madhe, por sëbashku me stafin e federatës besoj që do të bëjmë një punë të mire, duke ndjekur dhe vëzhguar me shumë kujdes të gjithë lojtarët e talentuar shqiptar kudo që ndodhen. Do të përpiqemi të prodhojmë lojë dhe futboll të bukur, e më pas të ndërtojmë futbollista për të shkuar në nivele më të larta tek ekipet përfaqësuese, që është edhe objektivi jonë kryesor.

AGUSTIN KOLA, U-17 FEMRA: FUTBOLLI FEMRAVE PO MASIVIZOHET

Kam luajtur për ekipin kombëtar, përpara se të filloja sportin kam pasur ëndërr të luajë për Shqipërinë, por gjëja më e bukur për mua është drejtimi dhe stërvitja e lojtareve të ekipit Kombëtar të femrave. Kënaqësia është shumë e madhe, këtu flitet për përfaqësimin e kombit dhe është një përgjegjësi shumë herë më e madhe se drejtimi në nivel klubesh. Unë jam marrë për shumë vite me futbollin e moshave, e kam ndjekur futbollin e femrave dhe dalloj se që në moshat e vogla ka filluar një masivizim. Shikoj një dëshirë më të madhe sot te femrat sesa te meshkujt. Po ti ndjekësh në stërvitje kanë më shumë grintë, janë shumë të dëgjueshme dhe janë më korrekte karshi punës që bëjmë ne trajnerët. Jam shumë optimist se me këtë skuadër do të arrijmë diçka të mire.

MARINGLEN KULE, U-19 FEMRA: NË FUTBOLLIN E FEMRAVE PO BËHET NJË PUNË E MIRË

Drejtimi i një ekipi kombëtar është përgjegjësi dhe një privilegj i madh, jam koshient për punën e madhe që më pret. Dua të falenderoj Presidentin Duka për besimin e dhënë, është një privilegj i madh për mua që të jem trajner i kombëtares së femrave U-19. Në përfaqësuesen që do të drejtoj ka vënd për të gjithë vajzat e talentuara që luajnë futboll, kam pritshmëri të mira dhe nga vajzat që luajnë jashtë që do ti bashkohen skuadrës në grumbullimet e radhës. Më parë është bërë një punë e mirë nga trajneri Dede, të vetmin problem që shikoj te kjo moshë është stërvitshmëria dhe angazhimi në klubet e tyre, dhe për këtë do të punojmë shumë dhe me klubet. Në futbollin e femrave po bëhet një punë e mirë dhe do të ketë rritje në vazhdimësi.

VIORESIN SINANI, KOMBËTARJA A FEMRA: NA PRET NJË PUNË E MADHE

Drejtimi i ekipit kombëtar të femrave është një emocion i madh. Kam kontribuar për shumë vite në futboll dhe tani ndodhem në një pozicion të ri, që sigurisht më jep emocione të veçanta. Dua të falenderoj drejtuesit e FSHF për besimin e dhënë. E kam shumë të qartë që më pret një punë e madhe por gjithmonë i kam preferuar sfidat. Deri në fillim të ndeshjeve eliminatorë do të punojmë për të gjetur elemente të reja. Kemi një bazë të mirë të ekipit sëbashku me vajzat që luajnë jashtë. Na nevojiten dhe 3-4 elemente të tjera që të konsolidohemi siç duhet dhe besoj se në eliminatorë do të zhvillojmë ndeshje të mira. Ne e dimë forcën e ekipit përfaqësues dhe mendoj se hap pas hapi do të rrisim nivelin dhe objektivat do të jenë më të larta. Ekipi që drejtoj ka arritur në rritje dhe është më kompakt, kjo edhe për faktin se eksperiencia vjen në rritje.



Për t'u ndjerë çdo ditë në formë

Uji i Skuadrës
Kombëtare
Shqiptare
të Futbollit



Nr. 1 në Cilësi




NEWS

EMANUELA RUSTA, E PARA ARBITRE FEMËR ME STEMËN E FIFA-S

Shqipëria për herë të parë në historinë e futbollit këtë vit do ketë dhe një arbitre me stemën e FIFA-s. Jemi duke folur për Emanuela Rustën, arbitre e talentuar nga Kolegjiumi i Elbasanit që ka thyer barrierat dhe do të përfaqësojë futbollin shqiptar në arenën ndërkombëtare. Në muajin janar, u zhvilluan në Lisbon të Portugalisë testime teorike e fizike me arbitrat e rinj të FIFA-s, meshkuj dhe femra, si dhe seminar një seminar informues. Në testimet fizike morën

pjesë 38 arbitre femra. Vetëm 4 prej tyre arritën ti kalojnë ato dhe Emanuela Rusta shkëlqyeu duke arritur rezultate maksimale. Në fund u zhvillua dhe testimi i Rregullores së Lojës ku Emanuela ka arritur rezultate shumë të mira. Rezultate të shkëlqyera këto nga Emanuela Rusta që tregojnë edhe njëherë rritjen e nivelit të arbitrimit shqiptar, si edhe zhvillimin e madh që ka pësuar futbollit femrave ku Rusta ka drejtuar ndeshje kampionati dhe kupe.



PRESIDENTI DUKA TAKOHET ME AMBASADORIN HUNGAREZ

Presidenti i FSHF-së, z. Armand Duka zhvilloi në muajin mars një takim me Ambasadorin e Hungarisë në Tiranë, z. Lorant Balla. Bashkëpunimi i mëtejshëm për të ardhmen e futbollit ishte në qendër të bisedës mes Ambasadorit, Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, Ilir Shulku. Gjatë takimit që u zhvillua në ambientet e FSHF, Presidenti Duka njohu Ambasadorin Balla me zhvillimet e mëdha që ka njohur futbollit shqiptar gjatë viteve të fundit, e që njohën kulmin me kualifikimin historik të Shqipërisë në finale të Kampionatit Evropian "Francë 2016", me investimet në infrastrukturën sportive si edhe me përgatitjet aktuale që po kryen ekipi përfaqësues për këto eliminatorë, të EURO 2020. Z. Balla, është një njohës i shkëlqyer i shqipes dhe shqiptarëve, pasi më herët ka shërbyer edhe si ambasador i Hungarisë në Kosovë. Presidenti Duka falenderoi Ambasadorin e Hungarisë për mbështetjen dhe për kujdesin që ai po tregon në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në aspektin sportiv, si edhe e ftoi që të jetë në stadium për të ndjekur ndeshjet e Shqipërisë në kualifikueset për EURO 2020.

FSHF FILLON BASHKËPUNIMIN ME QEVERINË NORVEGJESE PËR FUTBOLLIN E FEMRAVE

Per Ravn Omdal, ish Zëvendës President i UEFA-s dhe Federatës Norvegjeze të Futbollit vizitoi në muajin mars Federatën Shqiptare të Futbollit në kuadër të një fushate të ndërmarrë nga Qeveria norvegjeze dhe Federata e futbollit nordik për rritjen e numrit të femrave që angazhohen me futbollin në Rajonin e Ballkanit. Ky projekt shumë interesant do të shtrihet edhe në Kosovë, Maqedoninë Veriore, Bosnje Hercegovinë, Serbi dhe Malin e Zi. Zoti Omdal u prit në një takim nga Sekretari i Përgjithshëm Ilir Shulku, anëtar i Komitetit Ekzekutiv Vasil Bici dhe drejtues të tjerë të Federatës Shqiptare të Futbollit, në të cilin

diskutuan në lidhje me projektin e tyre për trajnimin e rreth 120 trajnereve të futbollit të femrave në vitet 2019-2021. Pas takimit dhe prezantimit të projektit të bashkëpunimit me FSHF, zoti Omdal foli për mikrofonat e FSHF TV. "Duhet të them se është një ndjenjë fantastike të vij përsëri në Shqipëri dhe të shohësh progresin që ka bërë ky vend. Ndoshta Norvegjia është disa vite para Shqipërisë për sa i përket futbollit të femrave sepse ne kemi investuar më shumë kohë në zhvillimin e tij. Por tashmë jemi partnerë me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe do mundohemi të zhvillojmë veçanërisht futbollin e femrave".



SEKRETARI SHULKU TAKIME ME DREJTUES TË LARTË TË UEFA-S

Sekretari i Përgjithshëm i FSHF-së, z.Illir Shulku ka marrë pjesë në takimin e Sekretarëve të Përgjithshëm të federatave anëtare të UEFA-s, organizuar në Stamboll, Turqi, në datat 6-8 mars 2019. Një takim tejet i rëndësishëm që kryesohej nga Sekretari i Përgjithshëm i UEFA-s, z. Theodore Theodoridis. Kjo tryezë e organizmit më të lartë të futbollit evropian, u përqëndrua në risinë e Strategjisë Dixhitale dhe Komerciale, që UEFA prezantoi përmes platformës OTT. Platformë ku të gjitha federatat mund të pasqyrojnë garat dhe kompeticionet përkatëse që organizojnë. Parimisht federatat anëtare dakortësuan që të drejtat komerciale për kompeticionet me ekipet kombëtare

A, të vijohet ti jepen në formë të centralizuar UEFA-s, si një eksperiencë e suksesshme. Gjithashtu takimi shqyrtoi formatin e kompeticioneve të moshave U-17 dhe U-19, me disa ndryshime që favorizojnë frekuencën e ndeshjeve dhe aktivizimin e lojtarëve të këtyre grup moshave. Poashtu në takim u diskutua edhe mbi qëndrimin e UEFA-s mbi propozimet e FIFA-s lidhur me riformatimin e Kupës së Botës për Klube dhe Ligen e Kombeve Globale. Sekretari i Përgjithshëm z. Shulku zhvilloi takime dypalëshe me përfaqësues të UEFA-s dhe federatave anëtare ku paraqiti edhe qëndrimin e Federatës Shqiptare të Futbollit në të njëjtën linjë me atë të institucionit qendror evropian të futbollit.



FSHF NË SEMINARIN E UEFA-S PËR FPF DHE LICENSIMET



Federata Shqiptare e Futbollit mori pjesë në muajin mars në ëorkshopin rajonal "Club Licensing & Fair Play Financial", i cili organizohej nga UEFA në kuadër të procesit të licensimit të klubeve për kampionatet vendase dhe garat që organizon qeveria e futbollit evropian. Në këtë seminar FSHF përfaqësohej nga Eduard Gjini, Menaxheri i Licensimeve, dhe Ledio Ndini, Ekspert Financiar. Fokus i këtij ëorkshopi dy ditor që u zhvillua në San Marino ishte përmirësimi i infrastrukturës së klubeve, ku fokusi më i madh ishte te infrastruktura e akademive, si guri themelut për një futboll në rritje të vazhdueshme. Pjesëmarrësit u njohën edhe me programin e UEFA-s për zhvillimin e të rinjve dhe rëndësinë që duhet ti kushtohet shëndetit të fëmijëve nëpër akademi. Futboli i femrave është një ndër prioritetet më të mëdha të UEFA-s, siç u theksua edhe nga Presidenti Ceferin në Kongresin e fundit të zhvilluar në Romë, dhe në këtë frymë përfaqësuesit e federatave të pranishme në San Marino janë trajnuar dhe orientuar për licensimin e ekipeve të femrave dhe ndihmën që duhet ti jepet futbollit të femrave në vazhdimësi. Zhvillimi i platformave të reja financiare dhe mënyrat e hedhjes së të dhënave nga klubet në këto platforma, në kuadër të procesit të aplikimit për një licensë të UEFA-s, ishte edhe pika më e rëndësishme e këtij ëorkshopi, ku ekspertët financiarë shpjeguan në detaje mënyrën sesi klubet, nëpërmjet federatave ku aderojnë, të respektojnë Fair Play financiar.

PRESIDENTI DUKA PRET HOMOLOGUN ANGLEZ

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, priti më 11 janar në një vizitë zyrtare Presidentin e Federatës Angleze të Futbollit, Greg Clarke. Duke falenderuar presidentin Duka për këtë pritje miqësore, z. Clarke u shpreh i impresionuar nga rritja që ka pësuar futbollit shqiptar në dekadën e fundit, dhe shprehu mbështetjen e institucionit që ai përfaqëson për Shqipërinë. "Jam i impresionuar nga rritja që ka pësuar futbollit shqiptar në dekadën e fundit. Një punë e mirë dhe arritje të mëdha janë shënuar nga një vend i vogël si Shqipëria. Ne do të llobojmë dhe nxisim fort UEFA-n dhe FIFA-n për të kontribuar më shumë për vendet në zhvillim. Sëbashku do të bashkëpunojmë ngushtësisht për të arritur suksese më të mëdha në të ardhmen", theksoi z. Clarke në takimin e zhvilluar në ambientet e FSHF-së. Presidenti Duka njohu homologun e tij anglez me zhvillimet që kanë ndodhur në futbollin shqiptar dekadën e fundit, arritjet dhe objektivat për të ardhmen. "Për ne është një kënaqësi e madhe që ju sot ndodhni këtu. Në këtë dekadë të fundit futbollit shqiptar ka pasur uljet dhe ngritjet e veta. Ne vlerësojmë shumë mbështetjen e madhe që ka dhënë FIFA dhe UEFA, pa ndihmën e tyre gjithçka që kemi arritur do të ishte shumë e vështirë të arrinim këtu ku jemi sot", u shpreh Armand Duka. Vizita e Presidentit Clarke vijoi në Shtëpinë e Futbollit dhe u përmbyll më pas në stadiumin "Arena Kombëtare".





FUTBOLLI NË SHKOLLA, FSHF LICENSON MËSUESIT E EDUKIMIT FIZIK

Futbolli në shkolla është një projekt shumë i ambicioz i Federatës Shqiptare të Futbollit, që synon të rrisë dhe zhvillojë sportin e futbollit në të gjithë shkollat 9 vjeçare të Shqipërisë. Ky projekt ka një natyrë sociale dhe është financuar nga UEFA e FSHF. Nëpërmjet këtij projekti, ashtu siç ka ndodhur edhe në vende të tjera të Europës Perëndimore ku është implementuar më parë, synohet forcimi i vlerave shoqërore nëpërmjet lojës magjike të futbollit. Përfutuesit e këtij projekti janë fëmijët e moshave nga 7 deri në 9 vjeç të cilët luajnë futboll brenda orëve të fiskulturës në shkolla pa pasur asnjë kosto për shkollën dhe prindërit, sepse gjithçka mbulohet nga FSHF Përfutuesit e dytë të këtij projekti janë mësuesit e Edukimit Fizik, të cilët për të zhvilluar orët e futbollit në shkolla kualifikohen dhe licensohen me licensën D, licensë e cila është sugjeruar dhe aprovuar nga UEFA. Mësuesit i nënshtrohen një kualifikimi disa ditor nga Sektori Edukimit pranë Federatës, me orë teorike dhe praktike, duke arritur të marrin njohuritë e duhura për të drejtuar një orë stërvitore futbollit. Ky proces për këtë vit ka filluar me mësuesit e Qarkut Fier, po vazhdon në Shkollat e Qarkut Elbasan e Shkodër, dhe në javët në vazhdim do të vijojë me mësuesit e Qarkut Tiranë, Durrës dhe Korçë.



LE SUTEBEL DO TË VESHË KOMBËTAREN SHQIPTARE

Kombëtarja shqiptare e futbollit do të vishet deri në vitin 2020 me kostume të personalizuara që do të realizohen nga Le Sutebel Atelier, një shtëpi mode franceze që vjen në Shqipëri pas një bashkëpunimi dhe eksperience me firmat më të mëdha të modës në botë si Dior dhe Chanel. Marrëveshja me Federatën Shqiptare të Futbollit ka pikësynime të larta në lidhje me "modën e lartë" mashkullore, për të cilat Kombëtarja Shqiptare duket se do të jetë

ambasadore perfekte. Ky bashkëpunim u konkretizua në prag të fazës kualifikuese për Euro 2020 dhe kostumet për lojtarët, trajnerët dhe drejtuesit e FSHF do të pasqyrojnë vlerat dhe stilin shqiptar. "Jemi të nderuar që jemi përzgjedhur për të veshur me kostume të personalizuara Kombëtaren shqiptare- është shprehur z. Mendes Dias, administratori i Le Sutebel – kjo për faktin se Kombëtarja është simboli i çdo shqiptari në të gjithë botën".

TRYEZA BE-UEFA, FUTBOLLI NGA 2020 NË AXHENDËN FINANCIARE EUROPIANE

Në muajin nëntor në Bruksel u zhvillua takimi strategjik ndërmjet Bashkimit Europian dhe UEFA-s mbi përfshirjen e futbollit në axhendën financiare europiane nga viti 2020 e në vazhdim. Takimi organizohet nga Komiteti Europian i Rajoneve dhe vlerësohet si historik nga pikëpamja e angazhimit dhe përfshirjes së BE-së në mbështetjen e futbollit si mënyra më e drejtpërdrejtë për sigurimin e kohezionit social. Komiteti Europian i Rajoneve dhe UEFA, nëpërmjet këtij takimi kërkojnë të ndërtojnë një urë lidhëse nëpërmjet instrumentit financiar të UEFA-s për investimet dhe Fondeve Euro-



piane Strukturore, të cilat janë dhe pjesa më e madhe e buxhetit të Qeverisë europiane të futbollit. Presidenti Duka mori pjesë në cilësinë e Zëvendës Presidentit të Komitetit HatTrick. Në këtë takim u nënvizua impakti pozitiv që futbollit ka në ekonomi, socializimin e rajoneve, shëndetin publik, dhe bashkëpunimin intensiv që UEFA ka me të gjitha strukturat e Bashkimit Europian. Gjatë takimit u diskutua

edhe mbi rëndësinë e Fondeve Strukturore Europiane, të cilat janë një mundësi konkrete për të forcuar financiarisht jo vetëm UEFA-n, por edhe federatat anëtare. Ky proces, nëpërmjet shtimit të fondeve për Federatat anëtare, si edhe ridimensionimin e influencës së UEFA-s, krijon kushtet e një bashkëpunimi me struktura të mirëfillta politike, si Komisioni Europian apo Komiteti Europian i Rajoneve.

RREGULLAT E LOJËS, FSHF TRAJNIME ME KLUBET

Sektori i Arbitrimit pranë FSHF-së, i drejtuar nga Sokol Jareci ka filluar një cikël trajnimesh në Kategorinë Superiore dhe Kategorinë e Parë, në lidhje me Rregullat e Lojës. Një nga trajnimet u zhvillua në klubin e FK Kukësit, ku Jareci foli përpara drejtuesve, trajnerëve dhe lojtarëve për rregullat e lojës dhe kujdesin që duhet të kenë lojtarët në zbatimin e rregullave dhe njohjen më të mirë të tyre.

"Duke marrë në konsideratë

se pjesa e dytë e këtij edicioni futbollistik do të jetë më e ngarkuar dhe vështirësia vjen në rritje, si për skuadrat që pretendojnë titullin kampion si edhe ekipet që zbresin një kategori më poshtë, filluam këtë seri trajnimesh. Janë ndeshje me vështirësi ku kërkohet interpretim sa më i saktë nga ana e arbitrave dhe sigurisht me këto rregulla të lojës duhet të njihen futbollistët dhe stafet përkatëse. Mjaft të diskutueshme në futbollin e sotëm janë rastet e prekjeve të topit me dorë, ku futbollistëve i prezantuar kriteret se kur një prekje me dorë duhet të ndëshkohet dhe kur nuk konsiderohet shkelje. Kriteret sesi ndëshkohen faullat e ndryshëm vecanërisht ato me KK brenda dhe jashtë zonës së penalltisë, ishin një pikë tjetër e seminarit." – ishin fjalët e Sokol Jareci.



PËRGJEGJËSIA SOCIALE

“Federata Shqiptare e Futbollit është një institucion që i kushton një rëndësi të madhe kauzave sociale dhe në asnjë moment nuk ka hezitur të kontribuojë për ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e shumë problematikave, duke zhvilluar marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë vendor dhe kombëtar”




Federata Shqiptare e Futbollit është një institucion që i kushton një rëndësi të madhe kauzave sociale dhe në asnjë moment nuk ka hezitur të kontribuojë për ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e shumë problematikave, duke zhvilluar marrëdhënie të qëndrueshme me partnerë vendor dhe kombëtar. Prej shumë vitesh FSHF është investuar për ti ardhur në ndihmë komuniteteve në vështirësi, shtresave të marginalizuara si dhe duke investuar financiarisht në projekte që kanë impakt social. Jemi koshient që sukcesi i këtyre projekteve të mbështetura nga institucioni i futbollit në Shqipëri do të sjellë kontribute për shoqërinë, dhe në këtë kuadër ne do të administrojmë më mirë shumë problematika që janë sot temë dite në shoqërinë tonë. Çdo vit qeveria futbollit shqiptar, Komiteti Ekzekutiv, do të miratojë fonde dhe projekte për përgjegjësinë sociale për të impaktuar sa më shumë, nisma, individë dhe komunitete që janë përballë vështirësive.

#METY

Në fund të muajit mars Federata Shqiptare e Futbollit ju bashkua fushatës ndërgjegjëse #METY, një fushatë kundër dhunës dhe abuzimit më të cilën përballen vajzat dhe gratë shqiptare kudo nëpër Shqipëri. MeTy është ndërmarrë nga organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” dhe Qendra për Veprim Social dhe Inovacion (KMOP), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Në të gjithë ndeshjet e javës së 26-të të Kategorisë Superiore dhe Kategorisë së Parë, futbollistët mbajtën mesazhin #METY që u stampua në faqet e lojtarëve, për t’u dërguar sinjalin e duhur atyre që janë duke përjetuar dhunë, dhe për theksuar se nuk mund dhe nuk duhet të heshtin më. Duke përdorur sportin si mjet komunikimi, kjo nismë kishte për synim ndërgjegjësimin e tifozëve, që asnjë formë dhune ndaj vajzave dhe grave nuk justifikohet.

FUTBOLLI NË KOPSHTET E SHOIPËRISË

FSHF dhe Fondacioni “Lorik Cana 5” kanë nisur bashkëpunimin midis tyre për të investuar në ndërtimin e fushave të futbollit për fëmijët e kopshteve,





për një të ardhme më të shëndetshme e më të mirë. Fëmijët janë fokusi ynë, dhe çdo para e investuar për një rini që merret me sport është një para që i rikthehet shoqëris në forma të tjera, kjo është edhe arsyeja që FSHF vendosi të investojë në Kopshtin 9, Elbasan. Ky ishte vetëm investimi i parë, projekti do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë, ku investimi i rradhës është në qytetin e Shkodrës. Në fjalën e tij gjatë përurimit të këtij investimi, Presidenti Duka nuk e fshehu gëzimin. “FSHF në strategjinë dhe objektivat e saj nuk ka vetëm futbollin profesionist, por ka në fokus të ndihmojë shumë jetën sociale të vendit në tërësi. Ky projekt që ne kemi mbështetur, është projekti që na gëzon më shumë sepse nuk shikojmë të ardhmen e afërt por të ardhmen e largët, duke investuar në një kopësht, duke ndikuar në jetën e këtyre fëmijëve, që të luajnë sport, të merren me sport, të edukohen me sport, të jenë të shëndetshëm dhe të bëhen sa më të mirë në

profesionet që do të kenë nesër në jetë. Sporti i edukon dhe zhvillon fëmijët, duke i ndihmuar në rrugëtimin e tyre në jetë”. Drejtuesi i fondacionit, Lorik Cana, theksoi: “Për ne nuk ka qenë e lehtë të zgjedhim mënyrën më të mirë se si mund të promovojmë vlerat e sportit në Shqipëri. Futbollit është një nga elementët që ka sjellë vetëm kënaqësi në vendin tonë dhe në momentet më të vështira, duke nxjerrë figura të shquara dhe që janë bërë shembull për brezat e rinj”.

FSHF PRANË FËMIJËVE TË QENDRËS XHONATAN

10 vjetori i Qendrës Xhonatan, një qendër që punon në Shqipëri për komunitetin e personave me Sindromën Doën, ishte momenti që Federata Shqiptare e Futbollit të rikthehej përsëri pranë fëmijëve të mrekullueshëm të kësaj qendre. Bashkëpunimi i FSHF me Qendrën Xhonatan kishte filluar në prag të ndeshjes Shqipëri-Skoci, ku fëmijët e qendrës ndoqën nga afër ndeshjen e ekipit kombëtar dhe u takuan me të gjithë lojtarët. Delegacioni i kryesuar nga Zv. Presidenti i Federatës z. Edvin Libohova, Drejtori Administrativ Kejdi Tomorri si edhe legjenda e futbollit shqiptar Sulejman Demollari, dhuruan topa futbollit për të rinjtë e kësaj qendre si edhe i dorëzuan themelueses së kësaj qendre, zonjës Oreada Kita një bluzë të Kombëtares shqiptare me firmat e të gjithë lojtarëve. Një surprizë e këndshme ishte përgatitur nga fëmijët e kësaj qendre, të cilit i dhuruan z. Libohova logon e Federatës e punuar nga fëmijët dhe vullnetarët e qendrës. Bashkëpunimi FSHF-Qendra Xhonatan do të vazhdojë me synimin për të ndërgjegjësuar, informuar si edhe promovuar të drejtat e nevojat e individëve me këtë sindromë që të jetojnë një jetë të shëndetshme, të pavarur dhe pranë sportit.

BAZË MATERIALE PËR EKIPIN E KOMUNITETIT EGJIPTIAN NË SHKODËR

Prej pothuajse një viti është ngritur në Shkodër ekipi i futbollit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian. Një iniciativë kjo e shoqatës “Për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian”, që kanë inkuadruar mbi 30 fëmijë të grupmoshës 10-13 vjeç në këtë skuadër. Ky ekip ka krijuar një shembull pozitiv në komunitet duke nxitur ndjenjën e përfaqësimit, uljen e braktisjes së shkollës, minimizimin e bullzimit dhe promovimin e rregullave ‘fair-play’ në fushën e lojës dhe në jetë për këta fëmijë. Për këta fëmijë, të cilët vijnë nga familje me vështirësi ekonomike, Federata Shqiptare e Futbollit vendosi të dhurojë të gjithë bazën materiale të nevojshme për një skuadër që të përfaqësohet denjësisht në kampionatin rajonal në qytetin e Shkodrës. Baza materiale ju dorëzua fëmijëve në një ceremoni shumë të bukur të zhvilluar në Shkodër në periudhën e festave të fundvitit.

SEZON I RI, EMOCIONE TË REJA

Federata Shqiptare e Futbollit, në bashkëpunim me Sponsorin Teknik Macron dhe agjencinë Pik Creative, ka realizuar një imazh të ri të Kombëtares i cili do të na shoqërojë përgjatë sfidave të reja

GAZMEND MALO



Është bërë traditë tashmë që uniforma e Kombëtares të rinovohet në çdo fillim sezoni. Edhe kësaj rradhe, në prag të fillimit të sezonit të ri kualifikues drejt Euro2020, Federata Shqiptare e Futbollit, në bashkëpunim me Sponsorin Teknik Macron dhe agjencinë Pik Creative, ka realizuar një imazh të ri të Kombëtares i cili do të na shoqërojë përgjatë sfidave të reja.

Në përgatitjen e imazhit të ri, i jemi referuar bagazhit të madh të Kombëtares ndër vite dhe një dëshire për të sjellë diçka të re. Sfida pra këtu është të ndryshojë, të rinovohemi duke i qëndruar besnik identitetit tonë.

Kështu si pikënisje, ne kemi ruajtur natyrisht ngjyrat kombëtare në uniformën e parë dhe kemi punuar me dy ngjyrat e tjera “teknike” të bardhën dhe të zezën. Në rastin e uniformës së parë, që është edhe përfaqësuesja e Kombëtares sonë, bluza e kuqe kombinohet me pantallona dhe çorape të

zeza ndërsa uniformat e tjera janë me një ngjyrë të vetme, e bardhë ose e zezë.

Cili është motivi grafik që dallon këtë uniformë të re të kombëtares? Si gjithmonë, vendimi ynë ishte ai i përdorimit të simbolit tonë kombëtar, shqiponjës, por i treguar në një formë të re, të ndryshme nga dy edicionet e para dhe mbi të gjitha me një kuptim të ri.

Nga një analizë e hollësishme e një shqiponje në fluturim, është përzgjedhur detaji i shpalosjes së krahëve të saj në momentin që është gati për fluturim. Ky detaj, në vijim është përpunuar dhe stilizuar në një formë gjeometrike e cila është vendosur në bluzë në mënyrë të shumëfishuar. Figura që krijohet është një simbolikë e dykrenares së flamurit ndërsa shumëfishimi i elementit bazë ka një tjetër simbolikë të rëndësishme: forca jonë qëndron tek bashkimi. Skuadra është e përbërë nga shumë lojtarë dhe



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

macron

IFORMA E RE E KOMBËTARES 2019 - 2020



bashkimi i të gjithë lojtarëve, jo vetëm lojtarët në fushë, por të gjithë lojtarët e përfshirë dhe të përkushtuar, të bashkuar, mund të na çojnë drejt suksesit. Vetëm të aplikuar të gjithë së bashku mund të formojnë simbolikën e shqiponjës, ashtu si dhe vetëm kur punojmë së bashku mund të arrijmë shumë duke formuar kështu një ekip.

Nëse do të shohim disi nga ana teknike uniformat mund të dallojmë bluzën e ashtuquajtur "home" ose bluzën kryesore e cila ka një prerje "slim fit" për të patur një paraqitje sa më elegante dhe me forma të theksuara. Materiali bazë ndërthuret me materialin teknik micromesh i cili mundëson një ajrosje optimale për lojtarët në momentet e sforcos së madhe në fushë.

Jaka e përzgjedhur për këtë model, për t'i dhënë më shumë paraqitje dhe elegancë është imitimi i një jake të bluzës "polo" me ngjyrë të zezë dhe borde të kuqe. Bluzat personalizohen

me logon e FSHF-së nga brenda dhe sloganin "Ti Shqipëri më jep nder" e marrë nga vargjet e poetit tonë të madh Naim Frashëri. Nga jashtë, në pjesën e majtë, mbi zemër është e vendosur logo e Ekipit Kombëtar me shqiponjën e flamurit dhe akronimin FSHF.

Në pjesën e pasme gjejmë të qendisur "Albania" në ngjyrë të zezë mbi të kuqe.

Bluza e bardhë dhe e zezë ruan të njëjtin koncept grafik dhe të njëjtin ndërtim ndërsa uniformat e portierit që duhet të ruajnë ngjyrat dhe specifikimet teknike do të jenë në ngjyrat jeshile fosforeshente, e verdhë fosforeshente dhe e zezë.

Uniformat e reja të kombëtares kanë qenë të disponueshme menjëherë pas prezantimit në dyqanin zyrtar të FSHF-së në rrugën e Elbasanit si dhe në dyqanin zyrtar online të FSHF-së në adresën www.fshf.org ku tifozët mund të porosisin me dërgesa që mundësohen në çdo cep të botës.

PASION, PËRKUSHTIM, KRENARI!



UNIONBANK

Banka që dua

**Mbështesim ëndrrën e
Kombëtares Shqiptare të Futbollit!**



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

ANËTARËSOHU

TANI TEK KLUBI

TIFOZËT E KOMBËTARES



DHE PËRFITO NGA AVANTAZHET E SHUMTA EKSKLUZIVE



100 VJET VLLAZNIA

“DJEPI” I FUTBOLLIT SHQIPTAR

Një shekull jetë për “topkëmbën” shkodrane.
Histori spikatëse tepër e nderuar dhe respektuar

Vllaznia e themeluar 100 vite më parë kë një histori të madhe, tepër interesante. Jubileu i veçantë, shumë i rëndësishëm, i themelimit të KEVllaznia, e gjeti skuadrën shkodrane, pioneren e futbollit shqiptar në 16 shkurtin e 2019-ës, jo aty ku Shkodra meriton të jetë. Ngjarje të bukura kanë kulmuar nga fitoret e trofeve të rëndësishëm, të 9 titujve kampionë të saj në Kategorinë Superiore (më 1945, 1946, 1972, 1974, 1978, 1983, 1992, 1998 dhe 2001), 6 kupa të Shqipërisë (më 1965, 1972, 1979, 1981, 1987 dhe 2008), dy Superkupave (më 1998 e 2000) dhe një titulli kampion në Kategorinë e Parë (më 1962). “Libri i Artë” i trofeve të fituar është një dëshmi e asaj tradite të pasur e pozitive të reflektuar në vite e në 10 dekada në të cilat Shkodra ka nderuar e pasuruar këndshëm arkivën e vlerave e traditave madhështore të saj. Pikërisht për këto arsye e shumë gjëra të tjera të

çmuara, Vllaznia gëzon një popullaritet të madh në masat e gjëra sportdashëse në Shqipëri dhe jo vetëm. Shkodra i ka dhënë futbollit shqiptar lojtarë mjaft të shquar. Në gjirin e kuqeblove kanë luajtur Mjeshtër të Mëdhenj si M.Dibra, P.Mirashi, M.Koxhja, P.Gjeloshi, B.Fakja, Z.Barbullushi, R.Ragami, S.Bizi, M.Zhega, V.Sinani, e shumë të tjerë. Vllaznia është sot skuadra që ka stadiumin më të ri e më modern. Impianti me emrin “Loro Borici” përfaqëson një emblemë në Shkodër e në Shqipëri. Në këtë stadium zhvillohen aktivitetet më të rëndësishme ndërombëtare të skuadrës sonë Përfaqësuese. Për sezonin aktual skuadra shkodrane e ka siguruar ngjitjen e rikthimin e saj në kategorinë superiore duke patur një diferencë të konsiderueshme pikësh ndaj ekipeve të tjera në grupin A të kategorisë së parë. Në të tilla rrethana futboli shkodran do rikthehet te lavdia e reputacioni i së shkuarës...



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

TURNËU I EKIPEVE PERFAQESUESE RAJONALE

EKIPET PJESEMARRESE:

TIRANA U17 U15 U13
DURRES U17 U15 U13

FIER U17 U15 U13
SHKODER U17 U15 U13

ELBASAN U17 U15 U13
KORÇE U17 U15 U13

KALENDARI I NDESHJEVE:

KOMPLEKSI SPORTIV "SHEFQET LAMÇJA" ELBASAN

DT.11.03.2019 (E HENE)

FIERI - ELBASANI U13 10:00
KORCA - FIERI U13 11:00
ELBASANI - KORCA U13 12:00

DT.12.03.2019 (E MARTE)

FIERI - ELBASANI U17 10:00
KORCA - FIERI U17 11:30
ELBASANI - KORCA U17 13:00

DT.13.03.2019 (E MERKURE)

FIERI - ELBASANI U15 10:00
KORCA - FIERI U15 11:30
ELBASANI - KORCA U15 13:00

DT.22.04.2019 (E HENE)

FIERI - ELBASANI U13 10:00
KORCA - FIERI U13 11:00
ELBASANI - KORCA U13 12:00

DT.23.04.2019 (E MARTE)

FIERI - ELBASANI U17 10:00
KORCA - FIERI U17 11:30
ELBASANI - KORCA U17 13:00

DT.24.04.2019 (E MERKURE)

FIERI - ELBASANI U15 10:00
KORCA - FIERI U15 11:30
ELBASANI - KORCA U15 13:00

DT.06.05.2019 (E HENE)

FIERI - ELBASANI U13 10:00
KORCA - FIERI U13 11:00
ELBASANI - KORCA U13 12:00

DT.07.05.2019 (E MARTE)

FIERI - ELBASANI U17 10:00
KORCA - FIERI U17 11:30
ELBASANI - KORCA U17 13:00

DT.08.05.2019 (E MERKURE)

FIERI - ELBASANI U15 10:00
KORCA - FIERI U15 11:30
ELBASANI - KORCA U15 13:00

KOMPLEKSI SPORTIV QENDRA E EKIPEVE KOMBETARE, KAMEZ

DT.11.03.2019 (E HENE)

TIRANA - DURRESI U17 10:00
SHKODRA - DURRESI U17 11:30
TIRANA - SHKODRA U17 13:00

DT.12.03.2019 (E MARTE)

TIRANA - DURRESI U15 10:00
SHKODRA - DURRESI U15 11:30
TIRANA - SHKODRA U15 13:00

DT.13.03.2019 (E MERKURE)

TIRANA - DURRESI U13 10:00
SHKODRA - DURRESI U13 11:00
TIRANA - SHKODRA U13 12:00

DT.22.04.2019 (E HENE)

TIRANA - DURRESI U17 10:00
SHKODRA - DURRESI U17 11:30
TIRANA - SHKODRA U17 13:00

DT.23.04.2019 (E MARTE)

TIRANA - DURRESI U15 10:00
SHKODRA - DURRESI U15 11:30
TIRANA - SHKODRA U15 13:00

DT.24.04.2019 (E MERKURE)

TIRANA - DURRESI U13 10:00
SHKODRA - DURRESI U13 11:00
TIRANA - SHKODRA U13 12:00

DT.06.05.2019 (E HENE)

TIRANA - DURRESI U17 10:00
SHKODRA - DURRESI U17 11:30
TIRANA - SHKODRA U17 13:00

DT.07.05.2019 (E MARTE)

TIRANA - DURRESI U15 10:00
SHKODRA - DURRESI U15 11:30
TIRANA - SHKODRA U15 13:00

DT.08.05.2019 (E MERKURE)

TIRANA - DURRESI U13 10:00
SHKODRA - DURRESI U13 11:00
TIRANA - SHKODRA U13 12:00

NDESHJET FINALE

KATEGORIA U13

DT.24.06.2019 (E HENE)

TIRANA - KORCA ORA 16:30
SHKODRA - FIER ORA 17:30
ELBASANI - DURRESI ORA 18:30

KATEGORIA U15

DT.25.06.2019 (E MARTE)

TIRANA - KORCA ORA 16:30
SHKODRA - FIER ORA 18:00
ELBASANI - DURRESI ORA 19:30

KATEGORIA U17

DT.26.06.2019 (E MERKURE)

TIRANA - KORCA ORA 16:30
SHKODRA - FIER ORA 18:00
ELBASANI - DURRESI ORA 19:30

SPORTS LAW AND ARBITRATION
PERSPECTIVE ON SELECTED

INTERNATIONAL

Tirana Intern

RISIA

EUROPA JURIDIKE ZBARKON NË TIRANË, WORKSHOP NDËRKOMBËTAR MBI TË DREJTËN SPORTIVE

Federata Shqiptare e Futbollit zhvilloj në muajin janar workshopin ndërkombëtar “Sports law and arbitration: a practical perspective on selected legal issues”, një iniciativë shumë

e guxishme kjo e Sektorit Juridik në FSHF. Ky workshop u organizua me synimin e qartë për ti ardhur në ndihmë profesionistëve të së Drejtës Sportive për të shkëmbyer eksperiencën,

A PRACTICAL
LEGAL ISSUES

WORKSHOP

18Th of January 2019
National Hotel, Room Balsha

www.fshf.org

praktika dhe ide lidhur me zhvillimet aktuale të jurisprudentës së CAS. Workshopi ishte konceptuar me 4 panele diskutimore, në të cilët referuan avokatë me eksperiencë, gjyqtarë të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Sportiv dhe drejtorë juridikë e disiplinorë të UEFA-s. Në fjalën përshëndetëse në nisje të këtij aktiviteti, Presidenti Armand Duka falenderoj organizatorët Dr. Blerina Xheraj dhe Aldi Topçiu, përfaqësuesit e klubeve, avokatët, drejtorët e UEFA-s dhe gjyqtarët e CAS Lausanne që morën pjesë. “Jam shumë i kënaqur që jam sot në këtë organizim, kur

kjo iniciativë u propozua menjëherë Komiteti Ekzekutiv e miratoi duke parë rëndësinë e drejtësisë sportive jo vetëm në futboll por në të gjithë sportin shqiptar. Sipas mendimit tonë, ka një mospërputhje të nivelit intelektual, juridik, të kapaciteteve që ka Shqipëria për të bërë drejtësi maksimale sportive. Pikërisht për këtë u pranua që të bëhet një workshop ndërkombëtar, për të shkëmbyer mendime. Askush nuk vjen këtu për të mësuar tjetrin, por për të shkëmbyer eksperiencat e tyre. Ky nuk do të jetë workshop-i apo aktiviteti i parë, por do të pasohet nga të tjerë në vijim. Nuk mund të mos ndalesha në fjalën

“Jam shumë i kënaqur që jam sot në këtë organizim, kur kjo iniciativë u propozua menjëherë Komiteti Ekzekutiv e miratoi duke parë rëndësinë e drejtësisë sportive jo vetëm në futboll por në të gjithë sportin shqiptar”

”

time me një falenderim për avokatin që ka mbrojtur Shqipërinë dhe Federatën Shqiptare në një çështje shumë të rëndësishme që në njëfarë mënyrë na bëri pjesë e Euro 2016, Dr. Antonio Rigozzi”. Bashkëorganizatorja e kësaj konference, Dr. Blerina Xheraj, që solli eksperiencën e saj nga Universiteti Gjenevës ku jep edhe mësim, u ndal te problemet dhe mungesat që ka drejtësia sportive në Shqipëri. “Nëse një student do donte të specializohej në fushën e sportit dhe arbitrazhit sportiv, do ta kishte të vështirë të gjente në Shqipëri një master që është i dedikuar për këtë fushë, dhe do i duhej të largohej nga Shqipëria për të studiuar dhe rritur profesionalist. Ne shpresojmë shumë që ky ëorkshop të ketë shërbyer për të mbushur këtë vakum që ekziston në mësimdhënie dhe specializim, dhe të ketë patur impaktin e duhur te klubet dhe ekspertët e pranishëm”. Ky workshop kishte si objektivi sjelljen pranë antarëve të FSHF dhe jo vetëm, zhvillimet më të fundit të drejtësisë sportive dhe praktikat ligjore sipas modeleve më të suksesshme europiane nëpërmjet eksperiencës dhe praktikës së emrave të mëdhenj si Angelo Rigopoulos, Jacques Bondallaz, Jacopo Tognon, Laura McCallum dhe Antonio Rigozzi.

I SHPEJTË, PROFESIONAL
EKSPRESI I VËRTETË NË ZYRËN TËNDE!

0
kosto




Mjafton të porositësh të paktën **100 kapsula** në muaj!

*Ekspresin e merr në përdorim pa kosto | *Sasia minimale mujore 100 kapsula | Për më tepër informacion Tel.+355 44 51 7002



Spitali Amerikan, përqafoje jetën!



Mjekët më të
mirë vendas
dhe të huaj



Ndërhyrje
komplekse



Teknologji
bashkëkohore



Standarte
ndërkombëtare



Spitali Amerikan

042 35 75 35 24h

www.spitaliamerikan.com



Profesionalizëm
dhe
përkujdesje



PANOJAT PANO

TANI I NDËRKOMBËTARIZUAR

Në dy ditë, 7-8 mars 2019 mes Gazetarëve Sportivë në Ulqin të Malit të Zi u zhvillua Edicioni i X-të i Kupës kushtuar “Mbretit” të futbollit shqiptar, Panajot Pano

Kishte nisur 10 vite më parë. Pa shumë “bujë”. Thjeshtë si një iniciativë tepër e dobishme. Por 80-vjetori i ditëlindjes së “Mbretit” Panajot Pano duhet mori vemendje të vecantë. Gazetari i RTVSH

Defrim Methasani, ka “skicuar” i pari konturet e kësaj veprimtarie, për të respektuar Panon e Madh. Ja ka mbërritur që të vendosë “shtylla” të forta tashmë duke ia ndryshuar disa herë “dizenjon” si emërtimit ashtu dhe cilësisë së një kupe me shumë vlera. Një veprimtari tanimë tradicionale, që mbledh e afron gazetarët sportivë të të gjitha trevave shqiptare por jo vetëm, mediat e shkruara dhe ato elektronike të Shqipërisë. Të flasësh e të luash vetëm futboll kalçetoje mer e jep kënaqësi, ndonëse luhet me format më të reduktuar se futbollit i madh. Është bukur, vërtetë që Gazetarët Sportivë përkujtojnë tashmë prej 10 edicionesh radhazi, “Mbretin” e futbollit Shqiptar, Panajot Panon. Lajtmotivi qëndror “Luaj për Panon” solli në vemendjen e gjithkujt të gjithë turnetë e ndërkombëtarizuar tashmë. Më i fundit u zhvillua në 2 ditë (7-8 mars 2019) në Ulqin të Malit të Zi. Pati mbresa e kujtime të pashlyeshme të cdo pjesmarrës i kësaj veprimtarie. Gazetarët sportivë me një organizim të përsosur dhe mbi të gjitha në bashkëpunim të ngushtë me një tjetrin,

Është bukur, vërtetë që Gazetarët Sportivë përkujtojnë tashmë prej 10 edicionesh radhazi, “Mbretin” e futbollit Shqiptar, Panajot Panon. Lajtmotivi qëndror “Luaj për Panon” solli në vemendjen e gjithkujt të gjithë turnetë e ndërkombëtarizuar tashmë



jo thjeshtë përkujtuan “Mbretin Pano” por aspirojnë të “fotokopjojnë” imazhin e tij në shumë versione. Madje duke sfiduar shumë syresh që janë marë sistematikisht me futboll si lojtarë apo trajnerë edhe “kompozime” interesante. Turneu Panajot Pano ka brënda tij gjithçka. Emocione e të veçanta pa fund, garë sportive e konkurrencë shumë të fortë, gola e spektakël si nëpër ndeshjet e mëdha. Të duket realisht se po sheh e ndjek futbollistë të “mëdhenj”, pasi gazetarët nuk dinë të thonë e thurin bukur vetëm fjalën si kontekst e si përmbajtje, por zhvillojnë dhe vetë praktikisht plot gjëra të këndshme të “mësuar” nga logjika e përditshme e profesionit.



GLOBUSTRAVEL

Say Globus Think Travel

www.globustravel.al

info@globustravel.al

+355 67 20 81 333

Rruga "Mine Peza",
Pranë kafe "Flora"
Tirana, Albania, 1001

NE JEMI NJË!

Krenarë që mbështesim
Kombëtaren Shqiptare
të Futbollit



E ardhmja
është emocionuese.

Ready?

